

“... Ç’është Shqipëria e tregon më shumë një kullë malësore, se të gjitha bulevardet e kryeqytetit” - **Indro Montanelli**



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 135, janar 2015**  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## REALIZIMET E VITIT 2014 **2** BAZË E SIGURTË E REALIZIMIT TË PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI” PËR VITIN 2015

Me punën e pa lodhur të anëtarëve të kryesisë dhe me mbështetjen e anëtarëve të Këshillit të Shoqatës dhe anëtarëve të saj, gjate vitit 2014 janë realizuar një sere veprimtarish në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të shoqërisë civile dhe kulturore, si me poshtë:

1-Gazeta “Dukagjini” në përgjithësi është botuar rregullisht në çdo muaj dhe ka dale numri 134 i saj. Janë bere përpjekje që ajo të shperndahet në Tirane, në Kurbin, në Lezhe, në Malësi të Madhe, në Shkodër dhe në Rrafshin e Dukagjinit.

## ZEF LEKAJ - NJË EMËR I MADH I MUZIKËS SHQIPTARE

Thonë se artisti nuk vdes kurrë, por edhe i vdekur fizikisht ai përsëri është midis nesh. Ai vjen nëpërmes shpirtit të tij tashme të kthyer n’ art, të lënë peng diku midis horizonteve; te një poezi, një roman, pikturë, film, teatër, te një ndërtesë, apo edhe rrugë a park.

Zef Lekaj është prezent midis nesh me tingullin muzikor të shkrirë në buzën e zemrën e secilit prej nesh. Na la mbi 250 këngë, shumë tablo muzikore, la poezi, përkthime, një roman të pabotuar e partitura këngësh të pa kënduara. Ai na la figurën e një burri të formuar plotësisht në luftëra e shkolla, majën e pedestalit artistik ku arriti, por edhe qëndresën mbinjerëzore të ferrit komunist nëpër burgjet e egra të atij rregjimesi.

**3**



## MEDIA SOCIALE DHE SHOQRIA CIVILE **4**

**KJO KA QENE TEMA E SEMINARIT TE ZHVILLUAR PER MEDIAT LOKALE TE SHKODRES NGA INSTITUTI SHQIPTAR I MEDIAS**

Instituti Shqiptar i Medias, në bashkëpunim me Universitetin LUIGJ GURAKUQI në Shkodër, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temën “Aktivizmi i ri: Media sociale dhe shoqëria civile.” Me datën 16 janar 2015, në praninë e dy grupeve studentesh të Degës së Gazetarisë e perfaqesueseve të medias lokale të Shkodres, ishin të pranishëm dhe perfaqesuesite gazetes “Dukagjini”, ku gazetari i mirënjohur Lutfi Dervishi trajtoi zhvillimet e sotme të medias sociale në informacionin e shpejte në kohe reale dhe drejtepërdrejte nga vendngjarja.

## NATA TRADICIONALE- FOLK 2015 **4**

Tashmë është bërë traditë që çdo fund viti ansambli folklorik « Treva e Dukagjini » të organizojë natën tradicionale në teatrin “Migjeni”, në këtë tempull të artit e kulturës të Veriut të Shqipërisë. Edhe në fund të vitit që lamë pas, me 21 dhjetor, u organizua evenimenti i 9-të me këngë, melodi e valle të reja, me krijimtaritë më të bukura të vitit, kryesisht të kantautorit Fran Kodra, i cili bashkë me Ndue Shytanin përbëjnë një dyshe me një prodhimtari folklorike më të madhe se askush tjetër në zonat e veriut, që bashkë me antarët e tjerë të ansamblit janë mjaft të kërkuar. Veprimtaritë e tyre kanë pasë progres nga viti në vit si në anën sasiore, por sidomos në cilësinë interpretuese.

Të organizosh veprimtari të tillë në teatrin “Migjeni” tregon vlerë artistike, forcë integruese në jetën urbane që nuk ka të krahasuar me të gjitha tërvesat e organizuara në mëngjezoret e ndryshme të qarkut Shkodër të marrura së bashku, të cilat gjithçka kanë veç art jo dhe nga viti në vit po vinë duke u shuar.

## Jo shtyllave të tensionit të lartë mbi këtë kulturë!

Historia e zbulimit zë fill në shekullin e XIX pas Krishtit kur historiani gjerman Heinrich Schlieman (H.Shlieman 1822-1890) nisur nga legjendat homeriane më 1879 zbulon Trojën. Lajmi i këtij zbulimi u përhap me shpejtësi në gjithë botën dhe shtypi i kohës e quajti “Zbulimi i shekullit”. Kjo gjetje bëri që qindra apasionantë, historianë, kureshtarë, thesarokërkues, hajdutë etj., t’i sulleshin vendeve historike që visheshin me legjenda. Këtë fat pati edhe Kalaja e Dalmacës dhe varret përreth.



Shënim: Shkrimi me titull “Shkodrës i duhen Martin Camaj e Mehmet Shpendi, botuar në numrin 134, ka për autor Prelë Milanin. Redaksia i kërkon falje autorit për këmbimin e autorësisë.

Mundësoi  
Botimin:  
**NDUE FTONI**



# REALIZIMET E VITIT 2014

## BAZË E SIGURTË E REALIZIMIT TË PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË SHOQATËS "ATDHETARE-DUKAGJINI" PËR VITIN 2015



Me punën e pa lodhur të anëtarëve të kryesisë dhe me mbështetjen e anëtarëve të Këshillit të Shoqatës dhe anëtarëve të saj, gjate vitit 2014 janë realizuar një sere veprimtarish në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të shoqërisë civile dhe kulturore, si me poshtë:

1-Gazeta "Dukagjini" në përgjithësi është botuar rregullisht në çdo muaj dhe ka dale numri 134 i saj. Janë bere përpjekje që ajo të shperndahet në Tirane, në Kurbin, në Lezhe, në Malësi të Madhe, në Shkodër dhe në Rrafshin e Dukagjinit.

2-Shoqata në bashkëpunim me Fototekën "Marubi" ka hap ekspozitën "Shan Pici-1938", të fotografit Shan Pici, i cili ka bere fotografi në përgjithësi në zonën e Dukagjinit, e cila u realizua me 15 shkurt të këtij viti. Në këtë ekspozite pati një pjesëmarrje të madhe nga Shkodra, ishte dhe familja Pici, së cilës ju dorëzua titulli "Mirënjohja e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"". Në të njëjtën kohe ju dha titulli dhe Fototekës "Marubi" për punën që kishte bere.

E veçanta e kësaj ekspozite ishte pjesëmarrësi Ndue Deda nga Shoshi, i cili në vitin 1938 ishte fotografua nga Shan Pici dhe fotoja e tij fëmijë në atë kohe, ishte e ekspozuar. Dhe drejtori i Fototekës "Marubi" i dha një album me fotografi te Shan Picit

3- Me datën 25-26 prill një përfaqësi e shoqatës për rreth 40 vete morën pjesë në Manifestimin "Zëri i vëllazërimit-2014" në Rrafshin e Dukagjinit, në Peje, në Istog, në Kline dhe në Deçan. Në komunën e Klinës u bë promovimi i studimit shkencor e historik, me titull "Kultura e Komanit dhe komanasit", me autor Ndoc Selimi, të cilit për punën e bere, ju dha dhe titulli "Mirënjohja e shoqatës Atdhetare-Dukagjini".

4-Me datën 1 maj ishim të ftuar në 12 vjetorin e Muzeut "Shtjefen Ivezaj" në Tuz dhe ne u përfaqësua me 20 vete. Kryesia e Shoqatës, Shtjefen Ivezaj i dha titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës", sekretari i shoqatës, Luigj Shyti

dhuroj disa libra nga botimet e tij, si dhe Zef Lulash Sokoli i dhuroj një xhamadan të punuar vete. Ata na bënë një pritje dhe respekt madhështor.

5-Me datën 17 maj, organizuam ne sallën "Kardinal Mikel Koliqi" dhënien e dokumentarit "Misteri i një Kreshte", me autor Mhill Vaten.

6- Me datën 13 dhjetor 2014 u be promovimi i librit studimohistorik e shkencor, me titull "Dukagjini, rrugëtim ne gjeneze", me autor Luigj Shyti

7-Gjate kësaj kohe janë bere përpjekje për t'u miratuar nga Këshilli i Bashkise së qytetit tone, kërkesa e jone për sheshin e vendosjes së dy monumenteve, te njeri i atdhetarit Mehmet Shpendit-me rastin e 100 vjetorit të rënies së tij dhe tjetri i albanologut Martin Camaj, me rastin e 90 vjetorit të lindjes së tij. Pas shume përpjekjesh ai u miratua, fale kontributit të Mhill Prronit-anëtar i këshillit dhe anëtar i kryesisë së shoqatës dhe i mbështetur nga Ndue Marashi dhe av. Bardhy Lohja. Ky i fundit në cilësinë e kryetarit të këtij Këshilli.

\*\*\*

Për të realizuar gjithë këto veprimtari është dashur një fond i caktuar. Dhe për këtë gjate këtij viti jane arkëtuar **557 425** lekë, prej tyre **534 300** leke nga 14 mundësorë: Ndue Ftoni, me 2 000 \$, 203 300 leke; Gjergj Leqejza, me 143 000 leke; komuna e Pultit, me 52 000 leke; Kole Çardaku, me 50 000 leke; komuna e Rrethinave, me 18 000 leke; Bal Vuksani, Mark Zhuri, Gjergj Vocaj dhe Tonin Kamberi me nga 10 000 leke; Pal Lera, me 6 000 leke; Agron Hasani, Lulash Gjeloşi dhe Gjin Brigja, me nga 5 000 leke. Veçohen në këtë ndihmese **Gjergj Leqejza, Ndue Ftoni, komuna e Pultit, Kole Çardaku dhe komuna e Rrethinave.**

Këto fonde janë shpenzuar për nxjerrjen e gazetës, për marrjen pjesë në manifestimin "Zëri i vëllazërimit-2014", në Kosove, për hapjen e ekspozitës fotografike, në bashkëpunim me fototekën "Marubi"-Shan-Pici-1938"; për marrjen pjesë në 12 vjetorin e hapjes së muzeut "SHTJEFEN IVEZAJ" në Tuz, për dhënien e dokumentarit "Misteri i një Kreshte", me autor Mhill Vata, për promovimin e librit "Dukagjini, rrugëtim ne gjeneze", me autor Luigj Shyti si dhe për mbajtjen e faqes së internetit të Shoqatës; për nevoja kancelarie të shoqatës e të tjera e të tjera.

E gjithë kjo pune e bere i dedikohet punës së palodhur të anëtarëve të kryesisë, të Këshillit të Shoqatës dhe degës së Tiranës, por në mënyrë të veçante falënderoj për punën e bere nga redaksia e gazetës me në krye Lazer Kodra, seksionin e ekonomisë-financës me në krye Mhill Prroni, kryetaren për marrëdhënie me publikun-Dukate Bregu, Kryetarin e Këshillit të shoqatës-Prele Shytani dhe sekretarin e këtij Këshilli-Aleks Dushi; kryetarin e degës së Tiranës-Zef Bari.

\*Me gjithë punën e bere ka pas dhe mos realizime, në veçanti në këto drejtime:

Me gjithë punën që është bere gjate këtij viti, ende vihet re një pritshmëri nga kryetaret e seksioneve, vihet re një pritshmëri nga redaksia e gazetës, vihet re një pritshmëri nga kryetaret e degëve të shoqatës! Nuk e di, sepse ndodh kjo, kur detyrat secili i ka të qarta ne statut dhe në programimin vjetor. Ky qëndrim nuk është i drejte dhe dëmtohen rende punën në realizimin e misionit të Shoqatës..

\*Ende vijon te mbetet problem mbledhja e kuotave. Kryetaret e degëve nuk po e kryejnë detyrën e tyre, por edhe anëtarët e shoqatës nuk po e zbatojnë detyrën e tyre, që brenda muajit janar te çdo viti te dorëzojnë kuotën, detyrim statusor. Urojme që për vitin 2015 të filloje zbatimi i këtij detyrimi në mbare anëtarësinë e shoqatës. Një anëtarë shoqate më tha një dite: Nuk po me merrem asnjëherë në Kosove se, edhe unë jam anëtar shoqate. Po, i thash, ke të drejte, por nuk ke paguar asnjëherë kuotën, prandaj nuk e di se kujt ja kërkon pergjegjësinë e mos marrjes pjesë ne veprimtaritë e shoqatës?! U largua pa e zgjate më tej. Sigurisht nuk më erdhi mire, por isha mbushe keq. Nuk vjen kryetari i shoqatës t'iu thotë jepni kuotën. Secili anëtar i shoqatës duhet të vije vete pranë kryetarit të degës e ta dorëzoje kuotën brenda muajin janar të çdo viti. Po të ishte zbatuar ky detyrim statusor, ne do të kishim një zyre pune dhe nuk do sillleshim sa andej e këtej dhe duke u lut here njërit e here tjetrit që të na japin mundësinë të zhvillojmë një takim pune. Prandaj, ju kryetaret e degëve, ju anëtarët e shoqatës dhe ju anëtarët e Këshillit të shoqatës duhet të jeni promotorët e arkëtimit të këtij detyrimi statusor, megjithëse edhe ju e keni të vështirë! E keni të vështirë se, shumica prej jush

nuk e ka paguar kuotën, se po të jeni ju mire me ligjin, do të ishit me aktiv. Kryetaret e degëve, seksionet e në kryesi, anëtarët e Këshillit të Shoqatës duhet të jene me aktiv. Askush nuk i ka detyruar të bëhen pjesë e shoqatës, askush nuk ju ka detyruar të bëhen pjesë e drejtimit të Shoqatës, perverse detyrimi moral për ti shërbyer vendit të tij, për ti shërbyer komunitetit të tij. Mire kane bere, por ka edhe disa detyrime morale qe duhen realizuar.

\*\*\*

Kryesia dhe Këshilli i Shoqatës, që u mblodh me datën 5 dhe 12 nëntor 2014 diskutuan mbi disa probleme që ka pas shoqata gjate vitit 2014:

1-Pozicioni i shoqatës pas reformës territoriale, pasi nuk ka një njësi vendor me këtë emër, me emrin Dukagjini. Pasi i diskutua, doli në përfundimin që shoqata duhet të marri përsipër një rol oponent me pushtetin vendor, me bashkinë e Shkodrës dhe me atë të Vau-dejës, në interes të komunitetit dukagjinas. Prandaj e shikoj të nevojshme të krijojmë një seksion për këtë qellim.

2- Një pune me e plote të behet me rininë dhe gruan.

3- Këshilli miratoi propozimet e kryesisë. Ne kryesi u zgjodh zonja Marie Ferosi, në detyrën e kryetares së seksionit në marrëdhënie me pushtetin vendor e deri atë qëndror; u zgjodh zonjusha Marinela Buxha në detyrën e kryetares së seksionit me gruan e rininë.

4-U tërhoq vëmendja për shpërndarjen dhe sigurimin e shitjes së gazetës "Dukagjini". Në çdo muaj po del gazeta dhe Kryetaret e degëve nuk interesohen, me përjashtim të degës së Tiranës dhe asaj të Malësisë së Madhe. Ka dale e po zë rrënjë mendimi i gabuar, që ne jemi të detyruar të shërbejmë pa asnjë llogari. Një gazete që bën 30 leke, t'ua japim falas. Kjo nuk është e drejte. Kryetaret e degëve të punojnë dhe të sigurojnë leket e gazetës.

5- Për vitin 2015 do të punohet në baze plani të veprimtarive të miratuar nga Këshilli i Shoqatës, si më poshtë:

a- Vijimi i nxjerrjes së gazetës "Dukagjini" e cila duhet të dali në çdo muaj, të hënën e fundit të çdo muaji dhe me cilësi e përmbajtje sa me të mire të mundshme. Nga muaj shkurt 2015, redaksia të mendoje për ta nxjerre atë me 16 faqe, duke shkurtuar sasinë e kopjeve, nga 500 kopje

që e kemi tani, në 300 kopje.

Në çdo muaj, Redaksia

b- Marrja pjesë në Manifestimin "Zëri i Vëllazërimit-2015" në Kosove. Shoqata "Martin Dreshaj", në vitin 2015 do të zhvillojë Manifestimin me datën **12-13 prill 2015**. Në këtë date ata, do të festojnë 15 vjetorin i themelimit të saj. Ne, duhet të mendojmë se me çfarë mund të përfaqësohemi në këtë manifestim të veçante të saj.

Muaji mars-prill 2015, Seksioni i veprimtarive kulturore e artistike

c- Marrja e masave për të përkujtuar 100 vjetorin e Qëndresës së Dukagjinit kundër Forcave Ushtarake malazeze dhe 90 vjetorin e lindjes së albanologut Martin Camaj.

Në këtë kuadër, do të ngrihen dy monumente, për atdhetarin Mehmet Shpendi dhe albanologun Martin Camaj ... Gjate gjithë vitit do të vijoj zbatimi i programit, por do të mbyllen në muajin korrik 2015.

Gjate gjithë periudhës janar-korrik 2015, por ne veçanti muajit korrik, Grupi koordinator, me në krye Sekretarin e Shoqatës, Luigj Shyti

4- Një udhëtim neper vendet historike të zonës së Dukagjinit, me një grup studente të fushave të ndryshme, si: histori, tradite, arkeologji, etnografi dhe kulture materiale e shpirtërore,

Gjate muajin qusht-shtator 2015, seksioni i gruas dhe rinise

\*\*\*

Besoj në përgjegjësinë dhe në përkushtimin e anëtarëve të shoqatës, të anëtarëve të Këshillit të Shoqatës dhe në Kryesine e saj, prandaj jo vetëm që do të realizojmë detyrat në përgjithësi për vitin 2015, por në veçanti do të ndërtojmë dy monumentet, njërin për atdhetarin Mehmet Shpendi dhe tjetrin për albanologun Martin Camaj. Viti 2015 do te jete viti jubilar i Mehmet Shpendit dhe Martin Camaj. Duke u mbështet nga komuniteti dukagjinas kudo jetojnë, në Dukagjin, në Shkodër, në Tirane, në gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, do të ndërtojmë monumentet përkatëse dhe do të inaugurojmë në muajin e kulmit jubilar të tyre, në muajin korrik 2015.

**NDUE SANAJ**  
Kryetari i Shoqatës  
"Atdhetare-Dukagjini"

# ZEF LEKAJ - NJË EMËR I MADH I MUZIKËS SHQIPTARE

Thonë se artisti nuk vdes kurrë, por edhe i vdekur fizikisht ai përsëri është midis nesh. Ai vjen nëpërmes shpirtit të tij tashme të kthyer në art, të lënë peng diku midis horizonteve; te një poezi, një roman, pikturë, film, teatër, te një ndërtesë, apo edhe rrugë a park.

Zef Lekaj është prezent midis nesh me tingullin muzikor të shkrirë në buzën e zemrën e secilit prej nesh. Na la mbi 250 këngë, shumë tablo muzikore, la poezi, përktihme, një roman të pabotuar e partitura këngësh të pa kënduara. Ai na la figurën e një burri të formuar plotësisht në luftëra e shkolla, majën e piedestalit artistik ku arriti, por edhe qëndresën mbinjerëzore të ferrit komunist nëpër burgjet e egra të diktaturës.

Shkodra, djepi që e përkundi kur u lind dhe i rriti shtatin në ato vite të arta, ku paqja dhe falja predikoheshin si virtyte të shenjta e deri te atmosfera e pushuar prej artit, do t'i plotësonin artistit të ardhshëm civilizimin e karakterit të tij. Shkodra u bë nëna e dytë, u bë çelësi i solit për të hyrë atje ku më vonë Zef Lekaj pyet vetën se gjatë jetës a do të bashkudhëtojë me Danten, Shekspirin, Petrarken, Manxonin, Mjeden, Fishtën ... Bet'hovenin, Moxartin, Verdin ... për të shtuar mandej mendueshëm se "... vargjet dhe tingujt më pëlqejnë..."

Patriotizmi i të riut 22 vjeçar dhe dashuria ndaj atdheut e brumosur ndër

breza e thërret t'i thotë "Jo" komunizmit, ferrës së kuqe, i cili do të therte e do të priste shpirtin e shqiptarëve, prandaj e kërkon ndërjegjja të rreshtohet në krahun e idealeve të larta demokratike e njerëzore, siç ishte në vitet e para të instalimit të diktaturës, kryengritja e Postribës që hyri në histori si e para revoltë e dhunshme kundër komunizmit në Evropë.

Ky patriotizëm i mohuar do t'i kush-tonte të riut, muzikantit të ardhshëm Zef Leka, emrin e urryer prej propagandës komuniste "i prekur politikisht".

Ishte një kohë pa kohë, kur grepat e orës shqiptare kishin ngelur te dymbëdhjeta e nuk dinin se ç'drejtim të merrnin; ishte koha ashtu siç thotë Migjeni se në mëngjes zgjohet njeriu me mendimin që "... kaloi dhe një natë e vështirë ...", ose Martin Camaj kur thotë: "Në muzg prek ballin e vet secili e ndjenë ndër gishta fillin e jetës e gëzohet". Nën këtë terror rritej e mirrte rrugë një brez i kryqëzuar, brezi i mesit i shekullit XX. Por talentet u munduan të gjejnë rrugën e mundimshme drejt njohjes me punë, me ndershmëri e dashuri, ashtu siç bëri edhe Zef Lekaj. Megjithëse talenti dhe puna e tij nuk u vlerësua asnjëherë nga zhuritë realisht, ai mundi të korrë duartrokitjet e spektatorëve dhe mbarë popullit ardashës duke i dhënë magji në thurjen e vargjeve të këngëve, në kompozimet

e mrekullueshme, në dirigjimet orkestrele, në drejtimin e shumë valleve ko-reografike, ku spikati niveli i lartë artistik duke korrur suksese e vende nderi e të para në garat e ansambleve të këngëve e valleve. Populli artdashës i Kuçovës, ku Zefi punoi vite me radhë, është dëshmitar i punës madhore që bëri ai në këtë qytet naftëtar duke i dhënë një emër të nderuar në lëmin e artit.

Bash kur pema e lartë kishte pjekur frutat dhe kur muzikanti, regjisor, kompozitori i zërit madh ishte me flatra të hapura mbi horizontin e artit, u gjet si gjithmonë në sistemet diktatoriale sharra e djallit e do ta kthente pemën përmbys. Në një mbledhje fronti të organizuar pabesisht nën emrin se muzikanti i qytetit do të dekorohet me ndonjë titull për punën e majat ku kishte arritur, Zef Lekaj i vihen hekurat në duar në faqe të tërë qytetit.

Faji i dijes dhe i inteligjencës edhe këtë rast u ndëshkua rëndë. Ai akuzohet se kishte lexuar Fishtën, se iu gjet në shtëpi një libër i Dostojevskit dhe se ishte mendjemadh dhe nuk kishte përshëndetur shefin e sigurimit të zonës. Për këtë autori i shumë këngëve që kishin lënë gjurmë te publiku dhe që kanë hyrë në fondin e artë të kulturës shqiptare si "Çobaneshë", "Moj e mira", "Njana moll e tjetra ftue", "Pash dy syt' e tu si drita", tekstin e këngës "Mbete gjith' ditën hi-

jeve" e te tjera e deri te kënga për fëmijë "Fatosi dhe qingji" që i dha vendin e dytë në shkallë republike, detyrohet t'i nënshtrohet për shtatë vjet rresht fatit të zi të burgut.

Në "Shënime nga burgu" vetë Zef Lekaj kujton: "kur më çuan në burgun e Ballshit u takova me shumë njerëz e personalitete si at Gjergj Vaten, Mark Demen (perktihyes i Virgjilit), Nikoll Daken (gjuhëtar), Kasem Trebeshinen (shkrimtar), Muhamet Kosovrastin (mjek), Frano Ilija, Zef Simoni, e te tjerë e te tjerë njerëz të dijes e të shkencës që vuanin dënimin e pamerituar". "Kështu kësaj inteligjence diktatura u dha titullin më të lartë-pat thënë një artist i dënuar - urdhrin më suprem: atë të vuajtjes dhe atë të vdekjes. Ky është vërtetimi më i saktë, se ata i donin letrat dhe artet më shumë se sa jetën. Vetëm ata janë artistë të vërtetë..."

Kam nëpër duar librin monografik kushtuar mjeshtrit, monografi që autori ia kushton babait të vet, duke i ngritë kështu një monument këtij prindi të mrekullueshëm që u dha jetë pesë fëmijëve duke i edukuar me ndershmëri e dashuri ndaj Zotit, atdheut e njerëzve. Ky libër na përcjell faqe mbas faqesh jetën e babait Zef, me një shkrim e stil të dalë prej dorës e penës së poetit e mikut tonë Leon Lekaj, ashtu siç din të shkruaj vetëm dora e pena e tij. Kështu pra, artistin e madh, me 28 shkurt të vitit 1999 e thërret Zoti për të shkruar simfoninë e qiellore dhe njerëzit e kujdesshëm në tokë, sa ishte gjallë e nderuan me tituj të lartë pas viteve 90', si "Krenaria e Qytetit", "Qytetar Nderi", si dhe "Urdhrin për Vepërimtari Patriotike të Klasit Parë".

Zef Lekaj mbetet ndër breza "Një artist nën pentagramë të kryqëzuar".

Nga Ndoc Selimi

## GJUHA JONË, SA E MIRË...!

Me këtë moto, në Treviso të Italisë u bë (ri) hapja e Shkollës Shqipe të Mësimin Plotësues.

Ishte kjo ide e shumë bashkatdhetarëve, mbi të gjitha edisa intelektualëve e arsimeve shqiptar, të përkrahur fuqimisht nga Shoqata ILIRIA dhe drejtuesit e sajë, duke zhvilluar bisedime të gjata me organet vendore dhe me një bashkëpunim të ndërsjellë me Ministrinë e Diasporës së Republikës së Kosovës. Andaj Shkolla Shqipe e MP e Trevisos vëpron nën ombrellën e Shoqatës ILIRIA, derisa tekste mësimore për tre nivelet e para, janë dhuratë nga Ministria e Diasporës Kosovës për nxënësit-vijues të MP.

Ky eveniment në formë të inaugurimit, u organizua të shtunën me 24 janar 2015 nga ora 16.00 në Paderno di Ponzano(TV), aty ku Shoqata ILIRIA zhvillon dhe shpalosë aktivitetet publike. Të pranishëm ishin drejtues të Shoqatës ILIRIA, mësimdhënës nga Shkolla Shqipe e Bassanos, drejtues nga Shoqata LIDHJA

PRIZRENIT, nxënës-vijues, prindër, mësues edhe dhe aktivistë të devotshëm të mërgatës së këtushme shqiptare.

Hapjen e këtij aktiviteti të rëndësishëm kombëtar shqiptar, e bëri Beqir Cikaqi, përgjegjës dhe njëri nga dy mësimdhënësit e Shkollës Shqipe të MP që po (ri) hapet. Z. Cikaqi, që në fillim ia dha fjalën presidentes së Shoqatës ILIRIA, zonjushës Ermira Zhuri.

Ermira Zuri, presidente e Shoqatës, ndër të tjera tha: "Falënderojë prindërit që nuk hezituan të i sjellin fëmijët që ditën e parë, falënderoi mësuesit Malsoren e Beqirin që kanë shprehur gadishmërinë të kontribuojnë në këto kushte. Ndërsa një falënderim të veçantë iu adresoi mësuesve të ardhur enkas nga Bassano del Grappa, znj. Merita Berdica-Kastrati e z. Ragip Thaqi, si dhe z. Bashkim Bekteshi nga San Zenone degli Ezzelini, të cilët kanë bërë dhjetëra kilometra për të na nderuar e duke na e sjellëpërvojën e tyre shumëvjeçare me SHSH të MP, me sugjerimet e tyre profesionale..."

Dhe vërtetë mysafirët e veçantë, përveç që uruan këtë aktivitet, nga përvoja e tyre paraqiten momente të veçanta dhe emocionuese për të pranishmit!

Merita Berdica-Kastrati, mësuese aktuale e SHSHMPnë Bassano del Grappa ndër të tjera u shprehë: "Ndihej shumë e lumtur që punojë me nxënësit shqiptar! Ani se vetëm njëherë në javë,

por, më besoni se me padurim tërë javën e pres të vijë dita e mësimin e të takohem me nxënësit. Aktiviteti me shkollën shqipe ishte një nga "terapitë" mjaftë e dobishme për tejkalimin e problemeve shëndetësore që kisha ma parë, e që tani ndihem shumë mirë...Urojë kolegët, Shoqatën, prindërit dhe vet nxënësit..."

RagipThaqi, mësues aktual i SHSHMP nëBassano del Grappa, u shprehë: "Ne kemi një përvojë mbi katër dhjetë vjeçare, dhe ndihemi krenar që sot nxënësit vijues tëShkollës Shqipe të Bassanos kanë arritur suksese të larta në të gjitha lëmit.. Derisa në Bassano mësimin shqip e përkrah dhe na financon profesori italian Vittorio Andolfato, një mik i devotshëm i shqiptarëve, pse(?) mostë kontribuojmë ne vete për të mirën e fëmijëve ton..."

Bashkim Bekteshi, ish mësues i Shkollës Bassanos dhe drejtues aktuali Shoqatës LIDHJA PRIZRENIT, shprehë: "I përcjelli përshëndetjet e mësueses nga Vlora që punon me SHSHMP në Shoqatën e vet, znj. Hedie Xhyheri. Gjithashtu uroi edhe në emrin tim...Puna dhe aktiviteti që po bëjmë në këto rrethana e kushte, shprehem lirisht se është vazhdimësi e rilindësve..."

Në këtë (ri) hapje inkuadrua me një falënderim për Shoqatën ILIRIA kishte edhe mësuesja me përvojë në Kosovë, e që këtu kishte ditën e parë të punës me profesionin e vet, znj. Malsore Shaqiri, e

cila potencoi: "FalënderojëShoqatën ILIRIA që ma mundësoi ti kthehem profesionit tim, kudo të jap maksimumin duke shpresuar se dota kem përkrahjen e vazhdueshme..."

Në këtë (ri)hapje kontribuon edhe disa nxënës me poezitë që interpretuan: Dëfrimi, me poezinë: "Shkolla Shqipe"; Betimi me:"Gjuha jonë"; Dafina me: "Atdheu"; etj.

Fjalë të bukura e miradije për këtë aktivitet u shprehën prindërit e pranishëm, si: Mehdiu, Bedriu, Fadili, Xhemajli, Naseri, etj. si dhe disa nga drejtuesit eShoqatës që ishin të pranishëm:Gjini, Blerina,etj

Nxënësve që ishin të pranishëm iu shpërndan librat falas dhuratë e Ministrisë Diasporës Kosovës të siguruar nga Shoqata ILIRIA. Gjithashtu të pranishmëve iu shpërnda revista periodike URA –Revistë për fëmijët e diasporës, gjithashtu botim i MD të R. Kosovës.

Duhet cekur se Shkolla shqipe e MP do të zhvillojë mësimin çdo të shtune nga ora 16.00 deri në ora 18.25 ( tri orë mësimi me nga '45 minuta dhe dy pauza nga '5min ). Librat janë falas. Prindërit nuk kanë obligime financiare. Mësuesit aktualisht janë vullnetar.

24 Janar 2015,  
Për ShoqatënILIRIA Treviso,  
Beqir Cikaqi

# Media sociale dhe shoqria civile

**KJO KA QENE TEMA E SEMINARIT TE ZHVILLUAR PER MEDIAT LOKALE TE SHKODRES NGA INSTITUTI SHQIPTAR I MEDIAS**

Instituti Shqiptar i Medias, në bashkëpunim me Universitetin LUIGJ GURAKUQI në Shkodër, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temën "Aktivizmi i ri: Media sociale dhe shoqëria civile." Me datën 16 janar 2015, ne praninë e dy grupeve studentesh të Degës së Gazetarise e perfaqesueseve të medias lokale të Shkodres, ishin të pranishëm dhe perfaqesuesite gazetes "Dukagjini", ku gazetari i mirënjohur Lutfi Dervishi trajtoi zhvillimet e sotme të medias sociale në informacionin e shpejte në kohe reale dhe drejtpërdrejte nga vendngjarja. Fale teknologjise se sote, ne vendin tone ka 1.3 milion të përdorimit të rrjetit social Facebook në shqipëri. Per të arritur kete zhvillim të numerit të ndjekseve radios ju deshën 38 vjet, 9 vjet televizorit, 8 ore Facebook-ut, 3 ore iPadit. Sot në shtëpi marrim leksione online pastaj bëjmë detyrat, perzgjedhim filma, emisione në kohën dhe orën që duam. Për të arritur tek ky publik, kerkohen njerëz të afte dhe profesioniste



për të dhene lajmin e pare. Por ndodh që mjaftëhere jepen lajme të pasakta, duke ndryshuar shifrat e fakte dhe duke patur njohuri të pakta në drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Prandaj është tepër e rëndësishme përvetsimi i normave baze të gazetarise dhe nevojat e shumta të dhenjes së informacionit të shpejte dhe të sakte. Nga studentet e gazetarise pati shume pyetje, të cilat morën përgjigje nga gazetari profesionist Lutfi Dervishi. Duke perfituar nga ky seminar, studentet dhe gazetarët falenderuan Institutin Shqiptar të Medias për ndihmën e afuar stafit të gazetave dhe punonjeseve që punojnë në mediat lokale në Shkodër. Dua të informoj opinionin dukagjinës se gazeta Dukagjini përveç pikave të shitjes së gazetes do ta gjeni në internet çdo numer të sajë në çdo vend të botës ku ndodheni dhe keni internet, me adresën: <http://www.shoqatadukagjini.com>.

Pergatiti  
**Zef Nika, Prel Milani**

## NATA TRADICIONALE-FOLK 2015

Tashmë është bërë traditë që çdo fund viti ansambli folklorik « Treva e Dukagjini » të organizojë natën tradicionale në teatrin "Migjeni", në këtë tempull të artit e kulturës të Veriut të Shqipërisë. Edhe në fund të vitit që lamë pas, me 21 dhjetor, u organizua evenimenti i 9-të me këngë, melodi e valle të reja, me krijimtaritë më të bukura të vitit, kryesisht të kantautorit Fran Kodra, i cili bashkë me Ndue Shtyanin përbëjnë një dyshe me një prodhimtari folklorike më të madhe se askush tjetër në zonat e veriut, që bashkë me antarët e tjerë të ansamblit janë mjaft të kërkuar. Veprimtaritë e tyre kanë pasë progres nga viti në vit si në anën sasiore, por sidomos në cilësinë interpretuese.

Të organizosh veprimtari të tillë në teatrin "Migjeni" tregon vlerë artistike, forcë integruese në jetën urbane që nuk ka të krahasuar me të gjitha tërvesat e organizuara në mëngjezoret e ndryshme të qarkut Shkodër të marrura së bashku, të cilat gjithçka kanë veç art jo dhe nga viti në vit po vinë duke u shuar.

Se sa mirë po integrohen dukagjinasi në jetën urbane e rreth saj, sa vlera qytetare kanë, duke mbyllë gojët e liga, e tregoj kultura në teatër duke mos shfaqur asnjë mangësi të para 10 viteve. Është shumë pozitiv fakti që pjesa më e madhe e interpretuesve të kësaj nate ishin dukagjinasi duke e shëndërruar këtë aktivitet në një manifestim të madh kulturor që fare mirë mund ta quajmë « Festivali tradicional i Dukagjinit ». Ishte i mirë gërshtuar elementi i ri me atë më me eksperiencë si në këngë ashtu edhe në

valle.

Binte në sy larmia e veshjeve tradicionale të gjithë të ruajtura me fanatizëm. Këtë koncerti ia rriti vlerat shoqërimi i çdo numri me një monitor, i cili paraqiste natyrën madhështore të bjeshkëve tona, me faunën, florën, ujvarat dhe burimet e shumta ujore të filmuara me profesionalizëm nga Mhill Vata. Krijimtaria dhe interpretimi në këngë, valle e veshje paraqesin vlera të mëdha nacionale që na bëjnë të ndihemi krenar për nga vime e kush jemi.

Dukagjini i besës, i bujarisë, i nderit e i flamurit, i dijes e mikpritjes, i këngës, i valles, i lahutës e çiftelisë, i xhamadanit e i xhubletës, i dokeve e i zakoneve të pa shoqe janë si pasaportë për ne dhe përbëjnë një pasuri të madhe nacionale që po transmetohet nga brezi në brez, për të cilat një rol të veçantë ka arti e kultura. I gjithë aktiviteti ishte folk duke ruajtur traditën të gërshtuar me të renë.

Sapo hapet skena na paraqitet i gjithë grupi në ritualet e një dasme pastaj fillon me këngë përshëndetëse "Mirë se keni ardhë" kënduar nga Bardhik Perbibaj shoqëruar nga grupi si dhe këngë dasme nga Gofile Papeleka dhe potpuri lirike nga Ndue Shtyani, Fran Kodra, Pllumb Vrinca, Gëzim Zefi dhe Gofile Papeleka. Trevesa në Dukagjin ka qënë e mangët pa miq, të cilët kanë qënë të mirseardhur sidomos ata nga Malësia e Madhe. E kush më mirë se këngëtari i mirnjohur Arben Delaj mund ta përfaqëson atë zonë, i cili erdhi me këngën e flamurit, i cili, me interpretimin cilësor fitoj duartrokitjet e zjarra të të pranishëmve. Ja disa vage të

kësaj kënge: "O flamur o gjama e motit / gjaku i valë i Kastriotit / Ded Gjon Lul me za kushtrimit / zjarri i zemrës së Naimit / Je jeleku i Mehmet Shpendit / je xhubleta e Norës Kelmendit / je vranina e Oso Kukes / anrra e bukur e Çun Mulës ...".

Është për tu vlerësuar maksimalisht ardhja nga emigrimi të disa këngëtarëve dukagjinasi enkas për këtë eveniment, duke dhene kontribut të shkelqyer me zërin e talentin e tyre. I tillë ishte Gjelosh Hajdari, i cili me këngën "Bjeshkët e mija" e bëri publikun për vete me forcën e vargut dhe cilësinë interpretuese. Shumë mbresëlënëse ishte interpretimi i bijës së tij Kristinës, të cilën në Venecia të Italisë e thërrasin "kanarina shqiptare", që e çoj peshë spektatorin me këngën "Jam shqiponja": "... Jam e vogël për me u pa / por peshoj sa shtatë keshjtjella / pesqind vjet se ndala flakën / Kastriot ta kam rrujt shpatën / ..." - jane disa nga vargjet e këngës.

Emir kryesor i këtij eventit, autori i teksteve të qindra këngëve të interpretuara nga këngëtar të ndryshëm të veriut e më gjërë, Fran Kodra u paraqit me këngën "Pse ke thanë nuk bëj mëkate" dhe ja disa vargjet e saj: "Në daç mëkate mos me ba / mbyllu mren mos del me t'pa / se faj nuk ka syni i shkretë / kur sheh bukur në këtë jetë / ...".

Përveç këngëve lirike, repertori i raportit Ndue Shtyani është shumë i pasur me figurat kryesore patriotike, për të cilat Dukagjini krenohet, që me interpretimin cilësor të tyre ju jep jetë. Edhe kësaj radhe u paraqit me një këngë për Deli Pjetër një ndër shtatë shaljanët, i cili me zërin

e tij të kthjellët si ujë i burimeve të bjeshkëve tona, fitoi duartrokitjet e zjarra të pjesmarrësve në koncert.

Gjithnjë Gjovalin Shani e bën shikuesin e dëgjuesin për vete me këngët e tija, të cilat e kanë pasuruar fondin e artë të folkut dukagjinasi. Një gjë të tillë bëri edhe kësaj radhe me këngën: "Moj Serbi moj shtrigë e zezë". Shumë i kërkuari dhe i kudo ndodhuri Pëllum Vrinca interpretoj këngën: "Kurr si lshoj trojet e mija" disa vargje të të ciles janë: Pasha gjakun e Kastriotit / besë flamurin e bjeshkëve të Hotit / Manastir e skelën e Vlorës / Nënë Terezën e tanë botës / kurrë si lshoj trojet e mija / ka i thonë emrit Iliria".

E pasuruan mjaft programin këngëtarët e përhershëm në natën tradicionale nga Nikaj-Mërturi: Zef Beka me një këngë lirike, Gofile Papeleka me këngën: "Babë e nanë si Diell e Hanë" dhe Bardhok Prebibaj, i cili me zërin e tij të ëmbël e kumbues interpretoj këngën: "Oj tokë malsije", me vargje shumë domethënëse si: "Ka me ardhë një kohë-ka me ardhë një ditë / Kena me lyp trojet-vendet ku jem rritë / Kena me lyp mrizat-kena me lyp krojet / kena me lyp djepat-me fole shqipiniet / se shpirti i njerit-nuk pushon i qetë / vetëm në ato vende-ku ka marrun jetë.

Me shumë vlera ishin edhe interpretimet e këngëtarëve të tjerë dukagjinasi: Nikë e Stela Thani, me këngën "Kjosh mallkue kurbet", Gjin Shani me këngën "Të pata dikur në dorë", Gëzim Zefi me këngë për Temal-Dushmanin, Vjola Shqau me këngën "Kthema zemrën" dhe këngëtari me zë melodioz Petrit Gjini, i cili u paraqit me një këngë liriko-gazmore me titull: "Bylmeti i fukarasë".

(vijon në faqen 8)

# Shtjefën Ivezaj, rilindasi shqiptar i kohës moderne

Kujtudo që i ka takuar të vizitojë Muzeun etnografik në lagjen Lekaj, Tuz, Mali i Zi, është befasuar nga një punë jo e zakonshme e një njeriu të thjeshtë, rreth të 80-tave, Shtjefën Ivezajt. Falë këtij investimi, së paku, prej 12 vitesh drejtori i këtij muzeu, z. Shtjefën Ivezaj nderohet në një mënyrë krejt të veçantë nga vizitorë të ndryshëm dhe mbarë Malesia përballë shpërfilljes, së plotë, deri në absurd ndaj veprës së tij, nga qeverisja lokale dhe qendrore në Mal të Zi, mjerisht edhe aty ku "qeverisin" shqiptarët.

Qytetërimet, që në gjenëzën e tyre, kanë nderuar investimet cilësore, në dobi të emancipimit të vet, kurse nderimi në fjalë, vjen disi ndryshe, sui-generis, jo thjesht, për ato që përmban, por, shumë më tepër se kaq, për motivin që e ka sjellur në jetë një vepër të tillë, si i pari i këtij lloji në tërë hapësirën natyrore të Malësisë së Madhe "Nderi i kombit". E, pra, aspak, thjesht për atë që na ofron si vlerë dhe pasuri me ineteres kombëtar, ajo thelbësorja, ardhja e tij në jetë, në kontekstin e një vetësakrilegji deri në absurd, falë shpirtit të madh prej atdhetari, ndryshe sjelljes prej patrioti iluminist në postiluminizëm, të arkitektit dhe menaxherit të kësaj pasurie sa lokale, po aq kombëtare, Shtjefën Ivezajt, sot kemi këtë arritje brilante, Muzeun etnografik në trevën tonë, në Malësi të Madhe.

Kaq, natyrisht, do të ishte e pamjaftueshme për të deshifruar vlerat dhe motivin e një përkushtimi të tillë, precedent në Shqipëri dhe shumë më gjërë nga z. Ivezaj, pa një shpalosje dhe njohje, larg frymës së provincializmit banal apo sentimentalizmit të sëmurë, të jetës së tij. Si mbaron shkollën fillore dhe atë 7-vjeçare në lagjen e tij, Lekaj të Komunes së Tuzit, Shtjefni i ri vazhdon shkollën profesionale 3-vjeçare, për tornitor, në kryeqytetin malazez, Podgoricë. Nga viti 1954 ushtron profesionin e bukur të fotografit, si amator, duke arritur të anëtarësohet në klubin e fotografëve dhe kinoamatorëve të Malit të Zi. Spiralja e suksesit tek ky djalos nuk do të mjaftohej me kaq. Si përfundon suksesshëm provimin para komisionit të ngritur

nga Komuna e Podgoricës, arrin të marrë licensën për hapjen e dyqanit, si fotograf, në Tuz afro 49 vite më parë.

Në vitin 1969 kalon suksesshëm provimin diferencial për fotograf, me rezultatin



shkëlqyeshëm, në Podgoricë. Falë pasionit dhe përkushtimit profesional ndaj fiksimit në celuloid, artit të mrekullueshëm të fotografisë, fotografi i parë malësor në Malesine e Madhe, në Mal të Zi, në vitin 1970 përgatit kartolinën e parë, brendësinë e së cilës do ta përbënin: Portreti i Flamurit tonë Kombëtar, portreti i Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti dhe portreti i Heroit të Popullit Dede Gjon Luli.

Këto kartolina u shpërndanë në tërë botën shqiptare, çka nga UDB-ja jugosllave u përjetua si një kërcënim serioz i "Vël-lazërim-Bashkimit", kësaj farse politike kobzeze, të mirënjohur nga shqiptarët, duke sjellë parburgimin e Ivezajt, gjithë vullnet dhe ëndrra të shëndetshme për të iluminuar dhe trashëguar vlerat tona nacionale, pa i hyrë në hak askujt në pjesën e tij të diellit ...

Fati sjell që kjo situatë parburgimi të ketë një fund të shpejtë, falë faktit që asokohe në Beograd ishte botuar, në gjuhën shqipe, libri i Nolit, kush-tuar Skënderbeut. Reagimi intelektual dhe fatlum i Ivezajt në

qelitet e UDB-së "Unë nuk e kam ditur që Skënderbeu është i ndaluar në gjuhën shqipe", bëri që i ndaluar të lirohet nga parburgosja, pasi "sqarohet" se Dede Gjon Luli është i ndaluar, por kartolina e tij, që sot ruhet në Muzeun Etnografik, pranë "Marubëve", do të "sistemohej" në fondin e librave të zinj të UDB-së, shërbimit të fshehtë jugosllav.

"Në këtë kontekst dhimbjeje, survejimi dhe persekutimi, i detyruar të mbijetoj, shpeshherë më ka qëlluar të nxjerrë jashtë ekzistencës tituj librash shumë të rëndësishëm, në emër të mbijetesës sa ekonomike, sa fizike", - mësojmë nga Ivezaj. Nga sa përçollëm më lart nuk është e vështirë të lexohet se rruga e këtij investimi shembullor prej atdhetari dhe intelektualit do të ishte një rrugë tejet e mundimshme: Përndjekje, përbuzje, diferencim diskriminues në të gjitha format nga politika zyrtare, antishqiptare, ndryshe sulme që do ta ndjeknin kudo, aq keqas sa do ta detyronin të shesë, me gjithë tokën, dyqanin e tij dhe ç'kish për të mbijetuar si familje dhe ruajturi, si të shenjtë, vlerat muzeale nacionale, të mbledhura me aq mundim, në një mjedis ku identiteti ynë nacionale rrezikohej rëndësisht. Dhe, padyshim, në rrugëtimin e çdo arritjeje, do të thonin psikologët, patjetër që duhet lexuar edhe ajo, e padukshmja, influenca e instinkteve të fjetura: Kështu nëna e tij, Drane Turmalaj nga Vrithi,

Shkrel-Malësi e Madhe, do të shquhej si koleksioniste e sapunit, e pullave të xhakave dhe të këmishave, veprimtari që trashëgohej edhe nga djali dhe vajza e Ivezajt, Martini dhe Drita, të dy banues aktualisht në SHBA, koleksione që sot ruhen pranë muzeut. Ndryshimet Demokratike, si tek cilido mes nesh sollën shpresën e një të ardhmeje plot zgjidhje në kontekstin demokratik sa lokal, sa nacionale, të shqetësimeve prej atdhetari dhe intelektualit të Ivezajt, njëherazi anëtar i Lidhjes Demokratike në Malësi, me kryetar, Nikollë Camaj, që në 1989-ën. Forumi i Intelektualëve në Ulqin, me kryetar Bahri Briskun, me kërkesën e Forumit intelektual shqiptar Tiranë, në vitin 2011, mbi bazën e propozimit të Klubit të Shkrimtarëve në Ulqin, me kryetar Nail Draga, e nderon me titullin "Ambasador i paqës i Koresë së Jugut", verifikuar nga ana e koreanëve jugorë. Në muajin maj të 2002-it, kur bindet se, jo vetëm qeverisja qendrore në Podgoricë, por as partitë politike shqiptare nuk po e ngrinin zërin,

përralshuar ndonjë sponsorizim modest, me efekt elektoral, pra jo me gjoks, as mes vedi, në mbështetje të një vlerë të tillë nacionale si Muzeu etnografik, "shembulli i shkëlqyer i një rilindasi në kohën tonë", i inicuar që në moshën 12 vjeçare, me koleksionimin e pullave postale, Ivezaj vendos të sakrifikojë banesën e tij, shtëpinë.

Gjithç'kishte, mobilje, orendi i largoi duke i zëvendësuar me mobilje në funksion të muzeut. Kater dhomat, korridori dhe ballkoni impromvizohen enkas për sistemimin e materialit muzeal. Nga fosili i kërmillit të gurëzuar, kosat ilire, shpatat, gurët e gjakut, veshjet e ndryshme për burra e gra, e të tjere e të tjera, përbëjnë atë pasuri që, normalisht, do të kërkonte një sipërfaqe prej 10 000 metra katrorë, "normalizohen" nga ana Ivezaj në shtëpinë e tij; Sakrilegj deri në absurd i një atdhetari të vërtetë!

E vetmja mbështetje e përhershme dhe e sinqertë e tij që bashkëshortja 76 vjeçare, invalide, pa pension, pa asistencë, kurse i vetmi stimulim moral "Për ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare" që nga ish-kryetari i komunës urbane të Tuzit, Maliq Çun Mulaj. Përballë kësaj gjendjeje Ivezaj pronari, drejtori dhe roja 24 orëshe e këtij objekti, kundrejt një pensioni prej 96 eurosh, kur një pension nacional, minimal, në Mal të Zi paguhet me 800 euro në muaj.

Më 24. 03. 2014 Shoqata patriotike "Malësia e Madhe" Nderi i kombit", përmes kryetarit të saj, Sytki Ndreca, në rrjetin social facebook, iu drejtua me një letër sensibilizuese Presidentit tonë të Republikës, Bujar Nishani; Kryeparlamentarit-Ilir Meta, Kryeministrit-Edi Rama si dhe Ministrit të Jashtëm-Ditmir Bushati lidhur me këtë status absurd të drejtorit të Muzeut etnografik të Malësisë, Shtjefën Ivezaj, megjithatë, deri tani, asnjë reagim. Dhe ky trajtim vazhdon, edhe pse nga Ivezaj, si atdhetar i klasit të parë, në një kontekst sakrilegji deri në absurd, ndryshe me një përkushtim iluminist në postiluminizëm, sukseset e këtij muzeu janë të habitshme. Filatelia me 35 000 pulla postale, fototeka me filmat, negativët e 40 viteve, si dhe biblioteka me 3 800 tituj ku ka edhe shumë libra muzealë në 4 gjuhë: shqip, serbisht, anglisht dhe gjermanisht, krahas vlerave dominuese etnografike, shënojnë një pasuri të shtuar kombëtare. Falë një sakrilegji të llojit të vet, sa personal, sa familjar duke na bërë krenarë për substancën tonë atdhetare, kur nën ethet e kulturpragmatizmit të egër, po harrojmë, jo

rrrallëherë të shkuarën tonë të vyer, hipotezën e së ardhmes sonë dinjitoze. Me statusin e kryetarit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Malësisë së Madhe "Nderi i kombit" personalisht, precedentin e krijuar me Muzeun etnografik shqiptar, më 13. 01. 2015 e kam ringritur si problem serioz edhe pranë Ministrisë sonë të Kulturës, tek Zef Çuni, Zëvendëministri i Kulturës, mora premtimin se, në bashkërendim veprimesh me faktorin shqiptar dhe qeverinë malazeze, homologët tanë, do të investohemi seriozisht për zgjidhjen e kësaj situatë absurde, një precedent që kompromenton edhe seriozitetin e angazhimeve integruese në BE të vetë Malit të Zi, çka nënkupton, mes tjerash, respektimin e trashëgimisë kulturore të pakicave. Një shpërfillje e tillë, e pafalshme, ndaj trashëgimisë kulturore shqiptare në Mal të Zi, bëhet akoma më absurde, përballë heshtjes sistematike, në të gjitha nivelet e pushtetit, kur, atje funksionon edhe një ministri e pakicave e drejtuar gjithnjë nga shqiptarët, krahas përfaqësuesve shqiptarë në parlamentin malazez, apo atë lokal në Tuz dhe Ulqin.

Koha e kësaj zgjidhjeje, koha e braktisjes së kësaj shpërfilljeje absurde ka ardhur, nëse si nacionalitet, konceptin rilindje, sikur atë të integritit të pari brenda vetes, ne dhe fqinj ynë i parë, Mali i Zi e kemi secili nesh seriozisht me vetveten. Pikërisht këtij misioni, rivlerësimit dhe mbështetjes reale, si një vlerë nacionale e shtuar, të Muzeut etnografik në Malësi, Mali i Zi, kam bindje se do t'i shërbejë edhe vizita që së shpejti pritet të zhvillojë në Tuz Zëvendësministri i Kulturës Zef Çuni.

Le të shpresojmë se dikur dhe dikush, vërtet, do të vërë dorë përballë kësaj shpërfilljeje zyrtare ndaj Muzeut etnografik shqiptar në Malësi, Tuz, Mali i Zi duke hijeshuar staturën e vetvetes sonë të munguar si nacionalitet, në mirëruajtjen dhe funksionimin normal të kësaj pasurie nacionale, në hapësirat tona, me koshiencën se të gjitha lëvizjet tona politike do të kthehen në iluzione të rreme brenda vetvetes, nëse nuk arrijmë të kuptojmë se integrimi real në Bashkimin Evropian, aq më pak bashkimi ynë nacional, nuk mund të arrihen pa bashkimin tonë shpirtëror, në funksion të të cilit vihen me aq shumë dinjitet dhe efizienz vepra të tilla si Muzeu etnografik në fjalë.

**Kadri Ujkaj**

studiuës, kritik letrar dhe kryetar i Forumit të Shkrimtarëve dhe Artistëve-Malesi e Madhe.

## ERDHEN FESTAT E MEDHA

28-29 Nandori janë dy nga ngjarjet më madhore të popullit shqiptar. 100 vjetori i shpalljes së Pavarësisë u festua me 1 000 qengja të pjekur dhe me një torte sa të madhe aq dhe qesharake, sikur Pavarësia të kishte ardhur me mish dhe ambelsina! ... Ndërsa për 29 Nandorin nuk u fol asnjë fjale! 28 Nandori na paraqiti si patriot, pashallarët kolaboracionistë, të cilët i shërbyen me devocion Perandorisë Osmane deri në grahmat e fundit! ... U anashkaluan burrat më të mëdhenj, që i shërbyen atdheut, qofshin këta edhe pashallarë. As kush nuk mund të aludojë për pashallarët, me veprim pozitiv si Ali Pashe Guçia, Aqif Pashe Elbasani, Haxhi Zeka, Preng Pashe-Bib Doda dhe në veçanti Hodo beg Sokoli, i cili duhet të kishte monumentin në mes të Shkodrës. Mbas vitit 1880, Perandoria Osmane e tregoi fytyrën e saj, kur në marrëveshje me Rusinë dhe Francën e shiten Shqipërinë të serbet e malazezet.

Për luftën Nacional-Çlirimtare, jam i mendimit se kundër pushtuesve nazifashiste dhe pavarësisht nga rryma ideologjike e PKSH, lufta ishte e drejtë dhe fitorja është meritë e pa kontestueshme e Ushtrisë Nacional Çlirimtare. Vepra e Enver Hoxhës nuk ka nevojë për koment. Verdiktin ja dha Populli me 21 shkurt 1991.

Lavdi veteraneve të Luftës Nacional-Çlirimtare!

Mark Bregu



# Jo shtyllave të tensionit të lartë mbi këtë kulturë!



Historia e zbulimit zë fill në shekullin e XIX pas Krishtit kur historiani gjerman Heinrich Schlieman (Henrik Shlieman 1822-1890) nisur nga legjendat homeri-

vendeve historike që visheshin me legjenda. Këtë fat pati edhe Kalaja e Dalmacës dhe varret përreth. Në mes të nekropulit ndodhej një lis që i bënte gjethet ndryshe nga të tjerët dhe populli e kishte pagëzuar si "Lisi i Floririt", sikur poshtë rrënjëve të tij fshiheshin kazanë me florinj. Kësaj legjende nuk i shpëtoi as Franz Baron von Nopcsa kur thotë më 1863 "...se po të zbulohet ky thesar, kuajtë nuk do të mbatheshin me hekur, por me ar!" (Nopcsa, "Fiset e Malësisë së Shqipërisë Veriore" A. I. Historisë Tiranë, dorëshkrim)

Rreth njëzet vjet më vonë pas bujës së Trojës, në janar të vitit 1898, ngjitet në

deri atëherë. Këto gjetje u bënë objekt diskutimi në qarqet e historianëve europianë të asaj kohe dhe për herë të parë u fol me gjysmë zëri për vazhdimësinë iliro-shqiptare të ekzistencës. Lënda e zbuluar prej tij gjendet në muzeun Saint Germain des France. Interesi dhe habia e këtij vendbanimi mesjetar tërhoqi vëmendjen e të gjithë arkeologëve dhe historianëve të Europës si Theodor Ippen, i cili boton dy libra historikë: "Starin iz Albania", Sarajevo, 1901 dhe "Denkmaler Verschiedener Altersstufen in Albanien", Wien, 1907 ("Kultura e Komani" fq. 16-22). Pastaj bënë dy vjet gjermime Paul Tragler, i cili boton librin "Mittheilungen und

të cilëve emra të njohur të historisë dhe kulturës europiane si: S.Reinah, L.Ugolini, L.Rei, H.Bule, D.Mustili, M.Garasanin, J.Kovaçiev, J.Koreshec, H.Cais, J.Werner si edhe shqiptarë si Shtjefen Gjeçovi e Etërit Jezuitë. Këta të fundit ngritën edhe një muze në Shkodër. Pra, siç shihet, interesi i botës kulturale-historike europiane tregon rëndësinë e kësaj qyteze mesjetare dhe potencën e saj.

Në verën e viti 1961 nisën gjermimet për herë të parë në Varrezat e Dalmacës nga arkeologët shqiptarë të udhëhequr nga profesorët e nderuar Hëna Spahiu dhe Skënder Anemali. Materiali i gjetur u grumbullua pranë Muzeut Arkeologjik në



ane më 1879 zbulon Trojën. Lajmi i këtij zbulimi u përhap me shpejtësi në gjithë botën dhe shtypi i kohës e quajti "Zbulimi i shekullit". Kjo gjetje bëri që qindra apasionantë, historianë, kureshtarë, thesarokërkues, hajdutë etj., t'i sulleshin

Kala të Dalmacës konsulli francez i akredituar në Shkodër Alexandre Degrand dhe nis gjermimet pikërisht te lisi i i legjendës, por lumturisht ai nuk gjen kazanë me florinj, por varre të vjetra e brenda tyre objekte e stoli të një kulture të panjohur



funde aus Albanien" më 1900 (Varreza e Dalmacës fq. 42-52). Lënda e grumbulluar prej tij ndodhet në Muzeun e Berlinit Konigl Museum fur Velkerkunde. Deri në fundin e Luftës Dytë Botërore, ky vend arkeologjik u bë pre e të huajve midis

Tiranë dhe arkeologët e historianët, pas analizave që iu bënë materialeve të gjetura u ra në një linjë me shumë studiues të huaj që e datojnë lulëzimin e kësaj kulture nga shekujt e VI-IX dhe që shtrihet deri në shekullin e XIII pas Krishtit. Për ta



bërë sa më prezent në qarqet ndërkom-bëtare trashëgiminë iliro-shqiptare, në vitin 1969 mbajnë një këshill shkencor në Tiranë, ku punimet e simpoziumit u botuan në shqip dhe në gjuhën frënge “Les Illyriens et gene des Albanies”, duke botuar punimet e tyre S.Anemali, M.Korkuti, B.Jubani, H.Ceka, 4E.Çabej, J.Gjinari dhe A.Gjergji. Kumtesa e arkeologes Hëna Spahiu gjendet e botuar te “Konferenca e Dytë e Studimeve Arkeologjike”, 1969, fq. 247-271. Më 1972 mbahet një tjetër simpozium me pjesëmarrjen e shumë përfaqësive të huaja. Arkeologët dhe historianët tanë shpallën haptazi e me fakte të pamohueshme para botës se shqiptarët janë pasardhësit direkt të ilirëve – tezë të cilën bota shkencore e pranoi plotësisht.

Stipçeviç thotë: “Kultura e Komanit është një kulturë e një populli që në shekullin VI-VIII ishte në kapërcyell të dy epokave, nga ajo e vonë antike, në periudhën e hershme mesjetare” (Stipçeviç,

irët”, Tiranë 2005, fq. 287).

Vendbanimi i mesjetës së hershme mbi Koman shtrihet në një sipërfaqe që i kalon të 90 ha dhe i kapërcen 2000 varre. Brenda dhe jashtë kësaj shtrirje gjenden rrënojat e 10 kishave të zbuluara deri tani si dhe një ipeshkëvi. Kështu vinë me radhë Kisha e Shën Ndreut, Kisha e Shën Katerinës në Bytyçin e Buzhalës, Kisha e Shën Gjergjit, Kisha e Shën Nikollës, Kisha e Shën Gjonit, Kisha e Shën Shirgjit (Sergjio), Kisha e Shën Mëhillit, Kisha e Shën Ndojit, Kisha e Shën Teodorit dhe Kisha e Shën Markut. Thuhet se është edhe një tjetër e quajtur e Shën Aleksandrit. Të gjitha këto kisha shtrihen në tokë e mbi tokë, por të tëra rrënoja, kur bota e përparuar i ka në këmbë e funksionale. Tash së fundi prej shtat vjetësh po punon ekspedita e udhëhequr nga arkeologjia Etleva Nallbani (Qendra Nacionale e Kërkimeve Shkencore franceze, Shkolla Franceze e Romës, në bashkëpunim me

tipit “Otranto”, të cilat deri tani mendohej se i mungonin këtij metropoli. Në një interviste për TV të vitit 2012 arkeologjia Nallbani thotë: “Jemi mësuar ta shohim përciptas Kulturën e Komanit, por tani që ky rajon po kthehet në referencë për studiuesit dhe arkeologët, sepse jep dijeni të bollshme dhe me tepër vlerë për periudhën e errët të historisë që ka një mungesë të plotë informacioni. Kërkimet dhe puna për ta kthyer në një muze të gjallë do të vazhdojë, sipas projektit, edhe për 20 vitet e ardhshme dhe atëherë do të jetë një ndër pikat turistike më të vizituara të vendit tonë” (Top-Channel TV, 2012). Por zonzjës Nallbani nuk do t’i shkonte kurrë ndër mend se tre vjet më vonë do planizohej një projekt shkatërrues i ëndrrave të saj dhe i gjithë asaj zone. Shumë kundërvënie ka pasur ky zbulim në dy shekujt e fundit dhe shumë kundërshtarë historikë si serb etj. janë munduar të hedhin tymra mbi këtë kul-

5Më datën 12 dhjetor 2014, me vendim nr. 367, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, i kryesuar nga Ministria e Kulturës znj.Mirela Kumbaro aprovojnë planin për kalimin e trasesë së tensionit të lartë OST Shqipëri-Kosovë në mes e paralel me vendbanimin mitik të Komanit ose sitin arkeologjik të tij duke i shkaktuar një dëm të pallogaritshëm historisë dhe arkeologjisë shqiptare përfshirë edhe atë ballkanike. Aprovimi i këtij plani në terren prish panoramën historike dhe atë natyrore, bën pamundësinë e vazhdimit të zbulimit të plotë të qytetit nëntokësor, ndikon në mjetet e sofistikuara elektronike e mikrovalëve, ndalon sponsorët e huaj për donacionet, largon turistët e shumë dëme të tjera si ambient duke e nxjerrë plotësisht në harresë njëzërë prej perlave arkeologjike të Shqipërisë. Në kuptimin e plotë të fjalës aprovimi i këtij plani me dashje apo pa dashje, nga padija apo nga pazotësia e informacioni i nevojshëm e ngarkon këtë komision me faj të rëndë para historisë, kombit e të ardhmes, prandaj të mos ngulet këmbë në krah të së keqes, kur nuk është akoma vonë për një devijim të tre deri katër shtyllave duke bërë të mundur shpëtimin e metropolit mesjetar dhe vazhdimin e punimeve për linjën e transmetimit Shqipëri-Kosovë.

Shumë pak e dinë se fshati piktoresk i Komanit është quajtur dikur “Misja e Vogël” dhe se shumë kalimtarë të huaj e kanë çmuar si një perlë të Veriut. E ardhmja e këtij fshati paraqet mundësinë e një turizmi natyror, ujqor, malor dhe arkeologjik. I vetmi fshat që i ka shpëtuar hemorragjisë dhe bjerrjes së popullsisë së viteve të fundit është pikërisht Komanit, të cilin po e boshatisim me duart tona. Prandaj i themi Jo projektit shkatërrues të linjës së tensionit të lartë OST mbi Koman si në zonën A, ashtu edhe në zonën B.

**Ndoc Selimi**



“Ilirët, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit”, Toena, 2002, fq. 72).

Ndërsa John Willkes thotë: “Teza shqiptare se varrezat e trevës Komanit përfaqësojnë një vazhdimësi mbështetë në një sërë argumentesh...” (J.Willkes, “Il-

Institutin arkeologjik të Qendrës së Studimeve Albanologjike në Shqipëri) dhe kundër asaj që ishte thënë deri në këtë kohë, kjo ekspeditë zbuloi një qytet të tërë të nëndheshëm, vend punimin e metalit si dhe qeramika dhe amfora të

turë dhe përgjithësisht mbi vazhdimësinë e ekzistencës iliro-shqiptare. Në Koman u ndërtua Hc më i madh i vendit dhe asnjë metër katror i metropolit në përgjithësi dhe as nekropolit në veçanti nuk është cenuar.

# DUKAGJINI NË LIBRIN E LUGJ SHYTTIT

Ky promovim është vërtete i pari për Luigjin tone, por ky libër është botimi i peste. Në fillim na është paraqite me librin publicistik me titullin "Dukagjini ka vend për të gjithë". Me vone na paraqiti vëllimin me poezi "Moj e mira në ortek të bores" dhe "Lamtumire mos me thuj" si dhe librin me titull "Gjurmët", çka tregon se i nderuari Luigj është tani pjese e grupit të studiuesve, është tani pjese e grupit të krijuesve

Më lejoni të falënderojë i nderuar Luigj, për guximin që keni marre të hyni dhe të studioni ketë hapësirë të madhe, ketë krahine me shume emër në historinë e Shqipërisë; për punën sistematike që keni bere në këto vite dhe jo pak, por një pune prej disa dekada, duke bubërruar nga pak e nga pak si ajo buburreca qe mbledh ushqimin e dimrit për të mbijetuar, për të kaluar dimrin dhe për të dale në pranvere. Aq, më tepër te të falënderojë se, keni bere përpjekjet maksimale për të mos rene në prehrin e megalomanisë të jo pak te njerëzve tone, e cila vijon edhe sot, e jo në pak raste na lenë prapa, na pengojnë për t'u marre nder-veti dhe për t'u bashkuar drejt së ardhmes.

Të falënderojë për sistemimin e kapitujve të këtij studimi dhe arritjen në nivel të kënaqshme pa ra në përsëritje të njëri-tjetrit se, jo në pak raste ka studime të mira, por që bien jo në pak raste në përsëritje brenda vetvetes.

Keni bere përpjekje të gjeni fjale dhe shprehje të bukura, mjaft domethënëse, të cilat e bëjnë më tërheqës lexuesin si, fjalët: "vjegca, vjegcat", "krahshitim, krahshittimit"; apo shprehjet: "Lëvizja e përjetshme e lavjerrësit vi-

jon, ... askush nuk mund t'i ndale ndryshimet e njerëzve ..., njomësi mendimi" e të tjera.

Keni bere një pune të madhe stu-



dimore, dhe jo thjeshte hulumtuese e evidentuese, të cilat janë të domosdoshme, por ajo që është më e rëndësishmja, është se, keni nxjerre përfundime të drejta, të arsyeshme, që dalin nga kapitulli i pare dhe deri te kapitulli i VIII, që është i fundit, të pranueshme nga palët në interes, duke i thonë jo megalomanisë të disave. Ju e keni dhënë në përgjithësi mendimin tuaj për secilin problem që shtroni. Kjo është shume e rëndësishme, që në mjaft studime nuk i gjejmë.

Me ketë studim disa dekada, dhe tani e kemi përpara relativisht është e lehte të themi mendimin tone pro ose

reografi Aldo Nika.

Shtuan të qëshurat dhe entuziazmin në teatrin Migjeni grupi "Gaz e Maraz" me të përherëshmit Gac Kodrina e Qazim Çela, të cilët me Gjovalin Mhillin me një humor politik, dhe këta me shokët e tyre humor me motive vallen e pingunëve. Është pozitiv fakti se humor po transmetohet nga brezi në brez. Kjo u pa edhe në koncertin në fjalë ku vogalushi që premtonte shumë në fushën e humorit Jozef Progni u paraqit me një parodi thumbuese ku subjektin e ven në një ëndërr që ka pa.

Ky eveniment folklorik, i vetmi në llojin e vet, u shfrytëzue nga Unioni artistik mbarë kombëtar për të vlerësuar grupin "Treva të Dukagjini" në përgjithësi dhe sidomos drejtuesit e tij për punën e bërë ndër vite për pasurimin e folkut shqiptar. Kesaj radhe Unioni i dha drejtorit të grupit, kengetarit Ndue Shytani titullin "Krenaria e Unionit", me motivacionin "Për krijimtari dhe interpretim të lartë artistik si rapsod dhe për organizimin e qindra veprimtarive artistike brenda e jashtë Atdheut", të cilit ia dorëzoi sekretari i përgjithshëm i Unionit, Mjeshtri i Madh Minella Kureta, "Mirënjohja e Shoqates "Atdhetare-Dukagjini". Titulli "

kundër. Por, ajo që më tërheq vëmendjen janë plote, por unë dua te ndalem:

Autori shume nocione i sqaron fare mire, si: Kush ka qene dhe është Pulti? Në hapësirën gjeografike të Pultit apo Pulatit u krijuan katër principata. Ajo e dukagjineve, spaneve, zaharijave dhe e dushmanëve. Kështu e gjithë popullsia e tyre është pultinas, atëherë dhe sot;

Del qarte se Dukagjini i Shkodres është në tokën e Pultit të Vogël;

Me argumente hedh poshtë mendimin se emri "MURR-i", që shume prej nesh e kane si "babën e pare të tyre, i cili është kthyer si Adami, por pa Even, që patjetër duhet të bëjmë përpjekje ta gjejmë bashkeshorten e Murrit ... hahata, nuk ka të bej me detin Adriatik, por me detin e Zi. Në ketë mes, në kapitullin e pare, na sqaron vendosjen dhe lëvizjen e fiseve të ndryshme në kohen e pellazgeve nga një hapësirë në tjetrin. Madje hedh idenë e guximshme se fiset Ilire lëvizën drejt lindjes dhe me vone erdhën përsëri në këto hapësira, çka tregon se Murri i takon lindjes dhe jo perëndimit. Deri tani është publikuar mendimi së hapësira e Dukagjinit apo e Alpeve janë populluar të detyruar nga pushtuesit, e cila ka brenda edhe të verteta. Pra, nga qyteti dhe nga fusha popullata ka lëvizur nga poshtë lart, kur arkeologet në vitin 2007-2008 amerikane e shkodrane kane zbuluar në rajonin e Grunasit në Theth, se këtu ka qene vendbanim i kohës së Bronzit, 3 000 vjet para lindjes së Jezuesit, kur nuk ekzistonin fare romaket dhe aq më pak otomanet. Në kohen e spaneve ishin 42 katunde. Në kapitullin trete, paraqet 16 fise, që 14 prej tyre janë larguar nga hapësira e

Mirënjohje e Unionit " iu dha biznesmenit Shkëlzen Delia dhe Luan Dagistanit, për kontribut në financimin dhe organizimin e veprimtarive artistike . Për organizimin e kësaj veprimtarie artistike meritë kanë edhe mundesoret e saj dukagjinas, të cilët me bujarinë e tyre po bëjnë që të mbahet gjallë jeta artistike e kulturore kudo ku ka dukagjinas . Të tillë ishin : biznesmeni Shkëlzen Delija, i përvitshmi dhe i palodhuri dukagjinaso-amerikani Ndue Ftoni, Xhovani 4 – SHPK , Pllumb Borshi-biznesmen i bukës "Thethi", Tonin Kamberi, komuna Pult me kryetar , Sokol Cubi, drejtorja pyjore Shkoder me drejtor, Gjin Brigja, pronari i bar-restorant "Floga" Lulash Martini, bar-restorant "Tradita", me pronar Gjon Duk-Gila; për veshjet Zef Lulashi e të tjerë. Këtë aktivitet e prezentoj me profesionalizëm, moderatorja Laura Plishta.

Të gjithë dukagjinasi duhet t'i jemi mirnjohës TV-Koplikut me drejtor, Zanel Hoxha, i cili e transmetoi të gjithë veprimtarinë, dhe jo vetem kete, por gjithë evnimentet artistike e kulturore që zhvillojmë, duke dhene një kontribut të shquar në promovimin e vlerave më të mira të Dukagjinit nëpërmjet këngës apo bisedave në studion e tij televizive.

E ritheksojmë se ishte koncerti më i mirë në repertor e cilësi interpretuese se të gjithë paraardhësit e organizuar në teatrin "Migjeni" nga grupi i Dukagjinit. Ju lumte!

Mendojmë se do të dilte akoma më cilësor po të kishte pjesmarrje më të gjërë duke përfshirë edhe të vetpërgjashuar apo të larguar, po të kishte edhe më shumë instrumentist të vjetër e të rinj, edhe më larmi veglash mizikore, sidomos fyell e lahutë. Do të ishte mirë, e urojme te realizohet me ndarjen e re administrative, duke i dhënë më shumë fonde artit e kulturës, që natës tradicionale t'i paraprihet me ndonjë festival folklorik midis zonave apo shkollave ku te dominojnë dukagjinasi, nepermjet te cilit të evidentohet elementi i ri dhe materiale të reja burimore në këngë. valle e instrumenta, për ta pasuruar natën tradicionale në fund të vitit.

Pultit të Vogël me pushtimin otoman të vendit ... Sa bukur e kuptim plot i referohet Homerit "Porsi gjethet në pyll, kështu janë fiset e njerëzve; disa i merr era e i çon neper toke andej e këndeje, kurse të tjerat i merr pylli që bulon dhe i lind gjate ngrohtësisë pranverore-fq. 20. Me këto që paraqet dhe argumenton autori na bën të qarte se duhet të largohemi nga disa nocione duke e paraqitur pushtuesin të mire ose të keq. Pushtuesi është vetëm i keq, dhe ne nuk duhet të jemi të njëanshëm ...

Paraqitet qarte se ne, dukagjinasi e Shkodrës nuk jemi pasardhësit e dinastisë së dukagjinëve, çka do të thotë që rastësisht na ka mbetur emri Dukagjin kësaj zone. Mund të kemi mendime të ndryshme për ketë, por në fakt është krejt e rastësishme që kjo zone quhet sot Dukagjin. Deri në vitin 1831, kjo zone quhej nahija e shpanëve ose e petershpanëve. Kjo popullsi duke përfshirë edhe Temal e Shllak është e re, vjen në ketë zone rreth fundit të shekullit XVI dhe fillimit të shekullit XVII. Pra është e re dhe vjen nga shume rajone e hapësira të tjera, që shumica e tyre ishin pjese e hapësirës së Pultit dhe më vone edhe e Dukagjinit. A mendohet që të ndryshojmë ketë emër? Jo! Kurrsesi JO! Por, duhet ta kemi të qarte se, ne nuk jemi pasardhësit e dinastisë së Dukagjinëve.

Të nderuar pjesëmarrës, kemi nevojë për studime të tilla, pa emocione, pa folklorizma, pa mentalitete primitive dhe pa nacionalizëm.

Edhe njëherë Luigj-faleminderit dhe na bashkoh përsëri e përsëri!

(vijon nga faqja 4)

Armela Mehmeti, nxënësj e cila beri emer jo vetëm në Shkoder në edicionin "Bilbilat e Shkodrës" duke marrë çmim por edhe në tërë Shqipërinë në formatin televiziv "Gjeniu i vogël", u paraqit shumë denjësisht në duet me të emën Bardhën në një baladë kurbeti. E ftuar speciale e grupit "Treva Dukagjini" edhe kësaj radhe ishte këngëtarja nga malësia e Tuzit, Marie Lajçaj, e cila edhe herë të tjera ka bashkpunuar me grupin e Dukagjinit. Në natën e fundit tradicionale u paraqit me një këngë kushtuar kombëtares tonë me subjekt nga ngjarja në Beograd në ndeshjen e 14 tetorit 2014. Këtë veprimtari e nderoj me pjesmarrjen e tij këngëtar nga Kosova Fadil Llukagjiu, i cili me zerin e tij brilant përshëndeti me dy këngë me të cilat fitoj duartrokitjet e publikut. Në shenjë respekti për Atë dhe kosovaret në përgjithësi, duar-arti në bërjen e rrobave tradicionale, Zef Lulash Sokoli i dhuroi artistit një xhamadan të punuar nga Ai. Fjalët e ndërsjellta të të dyve ishin shumë preke.

E zbukuruan skenën dhe gjallëruan programin grupi i vajzave të shkollës 9 vjeçare Vrakë pothuajse të gjitha dukagjinase dhe ai i valleve të drejtuara ngë ko-

Ansambli artistik të Dukagjinit i urojme suksese të metejshme e me faqe të bardhe në sherbim të artit e kultures së zonës së Dukagjinit!

Mirupafshim në koncertet e ardhshme!

Përgatite nga  
PRELE SHYTANI



# IKONA E MUZIKËS POPULLORE SHQIPTARE BUJAR QAMILI

Ikona e muzikës popullore shqiptare, Bujar Qamili, në një intervistë rrëfen jetën e tij: Nga muzika, koncertet, futbollin, problemet e muzikës së sotme dhe pse i ka refuzuar ofertat për t'u përfshirë në politikë.

**Emri juaj ka zënë rrënjë në muzikën popullore shqiptare dhe jo më kot juve ju kanë pagëzuar si "bilbili i këngës popullore shqiptare", veçanërisht asaj shkodrane. Edhe pse kohët kanë ndryshuar, në muzikë kanë hyrë rryma të reja... shumë shqiptarë e adhurojnë muzikën tuaj dhe do të donin t'ju shihnin më shpesh në festivale, evenimente të ndryshme apo media. Aktualisht me çfarë po merret Bujar Qamili, do të kemi së afërmi ndonjë projekt të ri tuajin muzikor?**

Po, është e vërtetë që unë kam krijuar një emër shumë të madh në muzikën popullore shqiptare, veçanërisht atë shkodrane. Edhe pse kohët kanë ndryshuar, unë kam vazhduar t'i qëndroj besnik kësaj kënge të bukur popullore, e cila ka dalë nga populli dhe që vazhdoj ta dua dhe ta ruaj këtë thesar të çmuar. Në përgjithësi të gjithë shqiptarët më duan dhe më vlerësojnë shumë për interpretimin që unë iu bëj këngëve popullore dhe që vazhdimisht në koncertet e përgjithshme, a po recitale ose show mund të jem ndër të vetmit këngëtar që nuk i mungoj spektatorit me daljet e mia në televizion ose koncertet e mia recitale që bëj për çdo vit. Tani sa kam mbaruar një turne tepër i bukur dhe shumë lodhës, por kur ke sukses dhe spektatori të pret mirë, lodhja nuk ndihet. Isha në Nju Jork, Detroid, Çikago, Nju Xhersi, Boston, me disa koncerte ku kaluam festat e fundvitit si krishtlindjet dhe Vitin e Ri me bashkatdhetarët e mi. Ishte një ndër turnet më të suksesshëm të jetës time artistike dhe tani po përgatitem për një koncert recital shumë i rëndësishëm, të cilin do ta lë surprizë dhe mendoj që do të jetë shumë i suksesshëm.

**Muzika ka qenë pjesë e pandarë e jetës tuaj, që nga fëmijëria e deri më tani. Cili interpretim ose festival ju ka lënë më shumë mbresa në karrierën tuaj artistike?**

Po, unë kam një jetë artistike shumëvjeçare ku sukseset dhe arritjet e mia janë të panumërta. Nuk e di se cilën të them më parë, pasi çdo koncert i imi ka qenë i suksesshëm dhe në rritje, qoftë në repertorin e këngëve të larmishme, qoftë edhe në ekzekutimin si nga ana e vokalit ashtu dhe e orkestracionit. Unë besoj tek vetja dhe te mbarë opinioni shqiptar brenda dhe jashtë Shqipërie, e them me bindje të plotë se kam arritur në majat e këngës popullore shqiptare, gjë të cilën vazhdoj ta ruaj me shumë kujdes, sepse kam parasysh një fjalë të urtë që thotë "më e vështirë është ta mbash se sa ta fitosh". Përsa i përket pyetjes tuaj që thoni kush iu ka ngelur në mendje nga koncertet, unë them që fundi mbahet mend. Pra

recitali i fundit në Pallatin e Kongreseve në Tiranë i cili ishte i mbushur me 2500 spektatorë, i cili titullohej "Aroma e këngës popullore".

**Cili është sikleti më i madh që ke kaluar në jetë?**



**Nëse nuk do të ishe këngëtar, çfarë do të ishe?**

E kam thënë edhe herë të tjera që futbollin është pjesë e jetës time. Jam tifoz. Me klubet në Europë jam me Bajernin. Si kombëtare dihet se jam me Shqipërinë, por tifoz edhe me kombëtaren gjermane dhe atë që nuk mund të rri pa e përmendur dhe që nuk e heq dot nga zemra, është Villaznia e Shkodrës. Pra, nëqoftëse nuk do u bëhesha këngëtar, do të bëhesha futbollist.

**A je i pasur Bujar?**

Absolutisht që jo, por bëj një jetë normale, më pëlqen shumë të dal me familje, pse jo dhe çdo ditë me shokë dhe të kaloj çaste të gëzuara. Kjo nuk më mungon.

**Ju shpesh udhëtoni edhe në koncerte të ndryshme jashtë vendit. A paguhet mirë një këngëtar sot?**

Po, pagesat bëhen në varësi, sa më larg të shkosh, aq më mirë është, por duke patur parasysh se para shumë e shumë vitesh, kemi kënduar si sot, është gjynah që të qahesh.

**E keni trashëguar muzikën në familje?**

Jo, nuk më ka kënduar njeri, siç i thonë në Shkodër nuk kanë ditur të bëjnë as hopa.

**Kujt i ka kënduar më shumë me këngët e tij Bujar Qamili?**

Në gjithë jetën time i kam kënduar luleve, të dashuruarve, qytetit tim, ku në një rast që nuk dua ta përmend, por intervista kërkon dhe këtë, ka qenë kënga kushtuar viktimave të 9 janarit të cilën e kam titulluar „Zëra në fund të detit“, ku pati një audiencë shumë të madhe dhe shumë prekëse.

**Sot, pas kaq shumë vitesh karriere muzikore, ndiheni i vlerësuar ju si këngëtar Bujar Qamili? Mendoni se është lënë në harresë brezi i artistëve të vjetër, jo vetëm në muzikë por edhe në aktrim, balet e zhanre të tjera të artit?**

Unë njihem një ndër artistët që kam arritur gjithçka. Kuptohet vetëm nëpërmes zërit tim. Jam vlerësuar me shumë

çmime:

1-Këngëtar i më i votuar me çmimin e publikut

2-Fitues i diskut të artë

3-Dy herë fitues i Festivalit të Interpretuesve të Këngës Popullore

4-Fitues i Maratonës së Këngës Popullore

5-I pranishëm në të gjitha koncertet tek "100 këngët e shekullit"

6-Dy herë pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, ku përveç qytetit tim kam qenë pjesëmarrës edhe me Ansamblin Shtetërorë të Këngëve dhe Valleve Popullore

7-Bashkia Shkodër më ka dhënë titullin e lartë "Mirënjohja e Qytetit"

8-Në vitin 2006 Presidenti i Republikës së Shqipërisë më dha titullin këngëtar i urdhërit "Naim Frashëri i Artë"

9- Në vitin 2010 Presidenti i Republikës së Shqipërisë më dha titullin e lartë "Mjeshtër i Madh"

**Shumë këngëtarë të brezit tuaj por jo vetëm, duke mos qenë të kënaqur me vlerësimin jo vetëm moral por edhe financiar, (nisur edhe nga mungesa e politikave në kulturë e art), merren sot edhe me aktivitete private, duke kënduar në pub-e, lokale e dasma e madje edhe në fushata elektorale. Ju jeni angazhuar me iniciativa të tilla?**

Faktikisht, nëqoftëse do t'i referohe mi statistikave është shumë e vështirë të gjesh një këngëtar në moshën time me këtë karrierë artistike që vazhdoj të këndoj dhe të kem sukses, sepse jam përkushtuar më shumë se çdo gjë tjetër skenës. Nuk këndo zakonisht ndër pub-e, lokale nate, etj, se kam pasur parimet e mia në këtë drejtim, por kënaqësia është në ambiente familjare. Mund të kem kënduar në ndonjë fushatë sepse njerëz jemi, kemi shokë edhe miq.

**Krahas momenteve të bukura që ka shënuar karriera juaj, a keni pasur edhe konflikte apo përplasje me kolegë apo emra të tjerë të fushës së artit? Kujtoni ndonjë rast?**

Kolegët i kam respektuar në maksimum. Nuk kam patur kurr konflikte me ta, sepse secili ka vendin e tij. Jam munduar t'i respektoj shumë, dhe këtë fakt kolegët e mi e dinë shumë mirë. Përsa i përket daljes në skenë, sidomos në konkurim, aty nuk njoh njeri, kush të jetë i zoti të fitojë.

**Sot në Shqipëri po i kushtohet më shumë rëndësi muzikës komerciale, larg të qenit një këngëtar i talentuar dhe profesionist. Ju si do ta vlerësonit muzikën që prodhohet dhe dëgjohet sot në Shqipëri?**

Kjo lloj muzike për të cilën ju po më pyetni, ishte kur ishte. Them se kaluan ato vite. Si çdo gjë në Shqipëri që po ndryshonte, u munduan të fusin edhe rryma të ndryshme muzikore, por ato nuk patën sukses. Edhe sot e kësaj dite ajo muzikë ekziston, por nuk ka forcën e duhur për ta

dominuar këngën popullore, sepse është bërë një punë e mirë me këngët popullore si nga RTSH, gjithashtu edhe nga TV Klan. Këto institucione në bashkëpunim me ne këngëtarët popullorë bëmë atë që populli e do. Ruajtëm dhe mbrojtëm këtë relike që populli jonë e ka të çmuar.

**Si e shikoni brezin e ri të artistëve, keni preferenca dhe vlerësime për emra konkretë? Cili do të ishte një apel apo mesazh dedikuar atyre që merren me muzikë sot?**

Nuk mendoj se është në interes të lexuesit të përmend emra apo të flas me superlativa, pasi populli i njeh dhe i do ata që janë këngëtarë. Unë them se çdo këngëtar i ri që del, nëqoftëse do të bëhet këngëtar dhe do që të bëjë emër siç e kam bërë unë, që në fillim ai duhet të ushqehet me këngën popullore shqiptare, sepse nuk do të zhgënjehet, por do ta ndjejë veten me të vërtetë këngëtar dhe të jem i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë me ju, këta këngëtarë po mungojnë. Unë them se brezi im është ndër ata breza që do të duhet kohë e gjatë për të arritur aty ku duhet, sepse ne jemi rritur në një ambient këngëtarësh që nuk do të harrohen kurr, si: Bik Ndoja, Shyqyri Alushi, Naile Hoxha, Valdete Hoxha, vëllezërit Medi e Demir Zena, Hafza e Zan Zyberi, Ibrahim Tukiqi e Xhevdet Hafizi, Meliha Doda, Bashkim Alibali, etj, që për momentin duhet t'u kërkoj falje që nuk po i përmend.

**Janë të shumta rastet, kur artistët përfshihen në politikë, ju keni pasur ndonjë ofertë për t'u përfshirë në të?**

Të them të drejtën dhe të jem korrekt me pyetjen dhe lexuesit, po jua them të vërtetën: Kam patur oferta nga parti politike si kandidat për deputet, apo në këshillin bashkiak, por i kam refuzuar, nuk kam pranuar sepse nuk dua të merrem me politikën, por kam menduar gjatë për karrierën time artistike që e kam fituar me zë dhe me mund, dhe nuk dua ta humbas dhe për ta ngatërruar atë me politikën.

**Duke qëndruar te qeveria, ligjet dhe nismat e reja. Kohët e fundit artistët shqiptarë janë mbledhur dhe i kanë kërkuar Ministrisë së Kulturës, të ulë moshën e daljes në pension nga 5 deri në 15 vjet sipas zhanrit, këngëtar, balerin, instrumentist etj. Ju ç'mendim keni?**

Që t'ju përgjigjem drejt është më se e domosdoshme për shumë arsye: E para, qoftë këngëtar, qoftë valltar ose balerin, aktor, instrumentist në moshën 67 vjeç nuk mund të këndohet, nuk mund të kërcëhet, nuk mund të lexohet një partitur dhe e dyta është që duhet të dalësh në pension për arsye sepse sot po mbarojnë akademinë shumë studentë dhe nuk po i jepet mundësia brezave të rinj, të cilët, unë mendoj se në të tilla raste janë të devotshëm dhe të domosdoshëm.

Nga RAMAZAN ÇEKA  
Janar 2015

# SHKURTE FEJZA, KËNGËTARJA E STUHISHME E LIRISË DHE E BASHKIMIT

Këngëtarja e mirënjohur kosovare, Shkurte Fejza, që në rininë e saj i kishte vënë vetes një detyrë të thjeshtë, por domethënëse; të bëhej shembull i civilizimit edhe për vajzat e tjera nga vendlindja e saj. Këtë detyrë e kishte menduar mirë para se ta merrte përsipër. Ajo pra u bë modeli më i mirë në rrugën e muzikës, por jo vetëm në këtë fushë, kur kemi parasysh rrethanat e fshatit në atë kohë. Si shkurta e lirë e maleve ajo do t'ua hapte rrugën edhe shoqeve të saj, që prindërit e tyre të mos i pengonin të këndojnë, ose të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. Në rrugën e saj kanë vazhduar një plejadë e tërë këngëtarësh nga Mushtishti.

Sprovat e para i përkasin kohës së moshës shkollore kur ajo ishte vetëm 7 vjeçe me interpretimin fëmijor të këngës „Isha vetëm tuj mendu“ dhe premisat që ajo premtonte me zërin e saj të mrekullueshëm nuk do të vononin të jepnin frytet e tyre. Kështu suksesin e saj të parë do ta shënonte në vitin 1975 në festivalin „Takimet e Majit“ ku u nderua me çmimin si „Debutuesja më e mirë“, duke shënuar kështu një kthesë në karrierën e saj muzikore, e cila do të vazhdonte e suksesshme deri sot e kësaj dite.

Vitet ,70 janë vite kur Kosova çlirohet paksa nga hegjemonia sllavo-komuniste e Beogradit dhe Shkurte Fejza si gjithë rinia kosovare, pavarësisht kufizimeve të rrepta nacionaliste, fillon të këndojë, por edhe të dëgjojë këngët dhe muzikën e bukur që vinte nga Shqipëria.

Njohja nga afër me këto këngë, me këtë muzikë, me këto këngëtarë do të bëhej realitet vetëm në vitin 1992 kur regjistroi edhe megahitin e parë për këtë udhëtim mes shqiptarëve me këngën: „N'xhamadanin vija-vija“, e cila edhe sot e kësaj dite këndohet si një himn nga të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Është e pamundur të shkruaj gjithë karrierën e gjatë dhe të suksesshme të saj në këtë shkrim. Nuk ka koncert ku këngët që këndon ajo të mos ndërpriten vazhdimisht nga duartrokjet e pjesëmarrësve. Shkurte Fejza ka bërë histori suksesi në Kosovë e Shqipëri, e cila është gdhendur në zemrat e shumë bashkëkombësve.

Shkurte Fejza në këto 40 vite karriere ka realizuar rreth 400 këngë dhe 35 albume nga emra të njohur kompozitorësh, autorësh shqiptarë e kosovarë. Një pjesë e këngëve të albumeve mban edhe firmën e saj ku ajo vjen si kantautore, duke u njohur edhe si një këngëtare që ka ruajtur vlerat e folklorit shqiptar.

Shkurte Fejza nuk mund të mungonte as në 100 vjetorin e Pavarësisë, kur nxori në treg albumin „100 këngë për 100 vjet“.

Profili i kësaj këngëtareje është cilësuar si një nga zërat e artë të Kosovës, një nga këngëtarët më të dashura nga të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Ajo shquhet jo vetëm për veçantinë e vokalit, por edhe për faktin që gjithë karrierën e saj muzikore e ka bazuar mbi tabanin

kombëtar.

Ajo ka përformuar gjithmonë me motive patriotike në repertorin e saj, një zgjedhje, një vendim të cilit i ka qëndruar vazhdimisht besnike si formë dhe si tematikë.

Ajo i takon asaj gjenerate rinore që për popullin e Kosovës ishte pararoja e luftës patriotike, ishte promotor që në situatat më të vështira qëndroi në ballë, duke kontribuar për lirinë me gjak, me intelig-



jiencë dhe me këngë.

Shkurte Fejza është pjesë e këtyre ngjarjeve historike dhe inspiruese e ndjenjave kombëtare. Ajo ishte atje me zërin e saj, me këngën e saj, me atdhedashurinë e saj, me shpirtin e lirë, me zemrën mbushur plot urrejtje ndaj okupatorit shekullor. Ajo fluturonte mbi malet, grykat e luginat, mbi fushën e Kosovës, mbi fshatrat e shkatërruar, për t'u çuar luftëtarëve të lirisë mesazhin e qendresës dhe të fitores, për t'u çuar mijëra e mijëra familjeve të masakruara mesazhin e shpresës.

Shkurte Fejza ka qenë pjesëmarrëse në ansamblin „Afërdita“, një shoqëri kulturore-artistike dhe nëpërmes kësaj shoqërie ato kanë dhënë koncerte gjithandej nëpër Kosovë duke shpërndarë mesazhe në këtë mënyrë dhe në këtë formë natyrisht mjaft të kufizuar e të censuruar.

„Ka qenë e vështirë, e bukur por e rëndësishme, gjithçka që kemi bërë në ato vite, kujton Shkurte Fejza, pushteti serb herë lëshonte pe, herë acaroej dhe na dënonte me burg, por ne rezistuem“.

Më poshtë, si për të dashur të largojë për pak çaste ato kujtime të hidhura, vazhdon: „Modeli im ka qenë këngëtarët e Shqipërisë, si nga veshja, ashtu edhe nga

performanca. Eh, tani kohërat kanë ndryshuar, vajzat kanë kushte për një paraqitje të mirë, por u them që të mos harrojnë edhe sharmin e viteve të shkuara“.

Shkuret Fejza është ndër zërat më të bukur dhe të fuqishëm, që kompeticionet muzikore kanë identifikuar në Kosovë dhe Shqipëri. Pas famës në vendin e vet ajo i tregoi botës shqiptare talentin dhe punën e saj.

Për Shkurte Fejzën vlerësimet janë pa

parë historike dhe lajmëtarja e realizimit të bashkimit kombëtar, që sot nuk është larg. Për këtë këngë, meritë të padiskutueshme kanë edhe dy artistët shkodranë, poeti Alfred Çapaliku dhe kompozitori Zef Çoba.

Albumet e Shkurte Fejzës përbëjnë një shifër rekord, një nga këngëtarët e rralla që ka kaq shumë këngë, me një repertor kaq të pasur. Janë 35 albume. Është vërtetë një punë e madhe, një sakrificë gjithashtu e madhe e cila është shpërblyer, pasi është krijuar një respekt dhe një vlerësim shumë i madh për emrin dhe meritat e kësaj këngëtare të madhe.

Për këto merita ajo është lauruar me çmimin „Mjeshtre e Madhe“ akorduar nga Presidenti i republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani në vitin 2013.

Ajo në marrdhënie me këngëtarët e mëdhenj të Kosovës, siç është edhe bilbili i këngës kosovare, siç e quajnë të gjithë, Nexhmije Pagarusha, ruan një raport, një respekt të krijuar ndër vite, pasi ajo ka qenë një idhull për të dhe gjithë brezin e saj, por pa lënë pas edhe kolegët e tjerë si: Ilir, Shaqiri, Shyhrete Beluli, Shaqir Cërvadiku, Nikoll Nikprelaj, Mahmut Ferhati, Motrat Mustafa, Remzie Osmani, Violeta Kukaj, Kumrije Buçaj, Vjollca Buçaj etj, si dhe kolegët e saj të nderuar nga Shqipëria: Bujar Qamili, Kastriot Tusha, Manjola Nallbani, Sabahete Vishnja, Irini Qirjako, Lirie Rasha, Fatmira Bërçani etj.

Siç e përmendëm edhe më lart, Shkurte Fejza këtë vit bën 40 vjet në skenë karriere artistike, që do t'ja kishte zili çdo këngëtar, a këngëtare. Kjo është një rrugë e gjatë, e vështirë, shpesh dramatike, por falë karakterit të saj gjithmonë e suksesshme.

Shifrat që po përmendim më poshtë nuk janë thjesht statistikë, por janë fryt i një pune të palodhur e pasionante të të gjithë krijimtarisë së këngëtares Shkurte Fejza.

Ajo ka interpretuar rreth 400 këngë popullore të trevave të ndryshme, por dhe të krijuesve më në zë të muzikës shqiptare, si soliste, por edhe rreth 40 due-te mjaft të suksesshme. Ky repertor kaq i gjërë është përmbledhur në rreth 40 albume, 20 videoklipe të cilët kanë zënë një vend të nderuar në fonotekën e muzikës shqiptare.

Shkurte Fejza ka realizuar mbi 50 recitale që kanë lënë gjurmë në të gjitha trevat shqiptare.

Duke pasur parasysh këtë aktivitet kaq të gjërë edhe unë e pata të vështirë të realizoi intervistën e mëposhtme me të, pasi karriera e saj, sukcesi i saj dhe kontributi i saj janë në përmasa të tilla që natyrisht nuk i mjaftojnë përmasat e këtij shkrimi.

**Znj. Shkurte, me pyetjet e mia do të përpiqem që së bashku të prekim disa nga arritjet tuaja dhe gjithashtu disa nga opinionet tuaja për muzikën bashkëkohore shqiptare, por gjatë bashkëbisedimit do të prekim edhe ndonjë detaj të jetës tuaj artistike, shoqërore e familja-**

re. Së pari është në interes të lexuesit të dijë diçka më tepër për bashkëpunimet tuaja me artistët e muzikës në Kosovë dhe në Shqipëri.

Është e natyrshme. Që në rininë time unë kam bashkëpunuar me shumë kompozitorë të njohur kosovarë si Xhevdet Gashi, Naim Krasniqi, Valton Beqiri, Burim Krasniqi, Medi Bajri, Sabah Bytyçi, Avni Qaili etj, me të cilët jam rritur dhe jam formuar si këngëtare. Tani i nderuar Ramazan, po të them diçka interesante: artistët e mëdhenj shqiptarë që do t'i përmendi më poshtë i kam njohur që heret, pa i takuar kurrë fizikisht, pra kam njohur veprën e tyre. U desh ardhja e demokracisë në fillimin e viteve '90 që unë t'i njihja nga afër dhe të bashkëpunoja me ta. Dhe këta janë të nderuarit kompozitorët e mëdhenj të Shqipërisë duke filluar nga Pjetër Gaci, Zef Çoba, Naim Gjoshi, Edmond Zhulali, Kol Susaj, Përparim Tomçini, Ilir Zoga si dhe shumë emra të tjerë që vërtetë i kanë dhënë një cilësi këngës sime.

**Krahas këtyre figurave të shquara të muzikës, ju keni bashkëpunuar edhe me autorët e teksteve që me fuqinë e fjalës i kanë dhënë fuqi e vlera këngës tuaj. Është me interes të dimë diçka më tepër edhe për këtë bashkëpunim.**

Po, frymëzimi i tyre poetik dhe tematik, ka qenë frymëzim edhe për mua dhe unë ato fjalë që poetëve u kanë dalë nga zemra i kam kënduar me të njëjtën forcë shpirtërore. Ta dini mirë se kur fjala bashkohet natyrshëm me muzikën, mesazhi është si një porosi që ne artistët kemi për

detyrë t'ja transmetojmë popullit. E pra, ti don disa emra. A mund të rri unë pa përmendur mjeshtrat e fjalës në Kosovë e Shqipëri si: Faruk Tasholli, Ymer Shkreli, Fatmir Muja, Bekim Lumi, Arsim Bonjaku, Bekim Mislimi, Avni Qaili, Sami Aliu, si dhe poetët nga Shqipëria: Gjok Beci, Jorgo Papingji, Hamit Alia, Alfred Çapaliku, Ramazan Çeka etj.

**Ky bashkëpunim për të cilin folët me kaq simpati a ju ka ndihmuar si kantautore, pasi keni kompozuar disa nga këngët tuaja?**

Po, më ka ndihmuar shumë dhe më ka rritur iniciativën që disa këngë t'i kompozoi edhe vetë dhe jam e kënaqur që janë këngë të cilat janë pëlqyer. Fillimisht e kam pasur shumë të vështirë, por duhet pasur kujdes se është një përgjegjësi. Kur e merr përsipër dhe merr guximin për të krijuar diçka, është eksperiencia shumë vjeçare me këngën që e mundëson të kesh një guxim të tillë që të krijosh.

Dua t'ju them se janë këngë që janë pritur mirë, bile mund të them se kompozimi im i parë ka qenë një hit, titulluar „Mbahu nënë e mos ke frikë“, i cili më bindi se edhe unë mund të realizoi këngë të tilla.

Megjithatë edhe pse sot vazhdoj, e kam me siklet këtë punë, sepse nuk e dua përgjegjësinë e dikuj tjetër.“

**Për të gjithë kosovarët Shqipëria ka qenë një ëndërr dhe një dashuri e pashoqe.**

Po, edhe për mua ishte e tillë. Një pjesë e madhe e kolegëve të mi pas viteve '90 kanë pasur ndoshta një dëshpërim fare

të vogël nga që Shqipëria e atëherëshme vuante ekonimikisht, jo sepse ne ishim më mirë, por kishim qejf ta shikonim Shqipërinë më mirë. Kjo për mua nuk e ka zbehur asnjëherë dashurinë për të dhe kur kam ardhë për herë të parë kam pasë qejf që kjo dashuri të kurorëzohet me një këngë, të cilën ta kem për karrierën time dhe shpirtin tim, si një kurorë të bukur që qëndron mbi të gjitha. Dhe kjo këngë titullohet: „N'xhamadanin vija-vija“.

Për këtë kemi shkruar në Shkodër së bashku me bashkëshortin tim Hajrushin dhe jemi takuar me kompozitorin Zef Çoba dhe me poetin Alfred Çapaliku, që më vonë do të ishin autorët e kësaj kënge dhe biseduam me ta. Ne u thamë se kemi dëshirë që udhëtimi i parë që kemi bërë në Shqipëri të promovohet me një këngë. Ne kishim gjetur temën dhe e kishim shkruar në formë proze gjithë atë që ndjenim dhe kishim dëshirë të shprehej përmes kësaj kënge, bile ne edhe kishim një varg që duhej patjetër të ishte në këngë. Ai ishte: Kam një lot m'pikon si ar', se ndër shekuj jam shqiptar. Mbi këtë motiv i nderuari z. Alfred Çapaliku e bëri një tekst të shkëlqyer, duke i dhënë shpirt ashtu si din ai dhe shfrytëzoi rastin edhe kësaj radhe ta falenderoj nga zemra. Kjo këngë tashmë ka lënë gjurmë të forta, të mëdha dhe të rëndësishme tek të gjithë, pasi është një ndër këngët më të bukura që e duam shumë.“

**A diskutoni me kolegët për këngët e reja që kanë filluar të dalin në treg, referuar brezit të ri, i cili nga një herë duket sikur është edhe duke gjetur veten,**

**ndonse një pjesë e mirë e tyre janë në sprovat e para të muzikës. Cili është opinionu juaj për këtë fakt?**

Muzika popullore... një pjesë e mirë herë pas here na vjen me motive orientale, të paktën ky është momentalisht opinionu im, por edhe i shumë të tjerëve që mendojnë kështu. Popullore të mirëfilltë autentike, jo shpesh dëgjojmë, ka devijuar muzika popullore. Përgjegjësia për këtë gjendje bie mbi ne këngëtarët, por edhe mbi kompozitorët, sepse duhet të punojnë më shumë me qëllim që muzika mos të mbetet në dorën e sajuesve të ndryshëm që njihen se gjoja kompozojnë këngë popullore.“

**Si e shikon këngën popullore?**

Është pasuria më e madhe që ka populli ynë në anën shpirtërore. Gjithçka e bukur e jetës sime, e dua shumë. Siç e thatë edhe ju më parë, për 35 albumet e mia, jo rastësisht unë kam trokitur në derën e kompozitorëve më të dëshmuar, të cilët i kanë dhënë vlera të mëdha këngës popullore shqiptare. Kam trokitur edhe në derën e kompozitorëve të Shqipërisë, natyrisht edhe të Kosovës, sepse Bullgaria, Italia, Greqia dhe Serbia nuk janë zbuluar tash nga kompozitorët e rinj, ato kanë qenë edhe më heret, mirëpo kemi patur një përgjegjësi, sepse edhe ne kemi ditur me saju, me vjedh, me kopju, me huazu e me e ba këngën lëmsh, por e kemi respektu këngën dhe kemi dashur edhe nga trashëgimia jonë kulturore, nga këngët tona të mirëfillta, të vjetra të cilat janë përpunuar e ripërpunuar.

(vijon në numrin e ardhshëm)

## Kritike letrare e Dr. Zejnepe Halili-Rexhepi për librin, me titull "PORTA TË HAPURA"

Pas një leximi të këndshëm të vëllimit poetik "Porta të hapura" e autores Shefqete Gosalci!

E djeshmja dhe e sotmja e luftëtares nën magjinë e vargut, ndjenjës dhe formësimit poetik të vëllimit "Porta të hapura" të poetes Shefqete Gosalci, kupton se ajo shkruan me pasion dhe maturi njëkohësisht, ndien me shpirt, teksa gjykon si dëshmitare ngjarjesh të rëndësishme kombëtare. Poezia nuk krijohet vetëm me qëllimin ndaj vetvetes, ndonëse pikërisht emocion brenda saj i jep rrjedhë drejt kuptimit më të gjerë. Poetja, e transmeton bindshëm subjektin lirik, duke u bërë e pranishme me po të njëjtën vëmendje e mjeshhtëri vargëzimi edhe në veprën e tretë "Porta të hapura", ku përkushtimi është akoma më i theksuar pas dy veprash poetike: "Gjaku gjakut i përgjigjet" (2002) dhe "Më ke urë në qiell" (2007).

Ideja poetike në këtë vepër përcillet, jo vetëm me shkathtësinë krijuese, por edhe me universalizmin e imazhit kur "dhembjes i shemben kullat". Shefqete Gosalci, është poetja që "një diell me rreze shpate...", është vasha shqiptare që nuk e la të përgjakur Atdheun, për një udhëtim ëndërrash të kristalta. Fakti që, poezitë e Shefqetes janë shkruar me vrull gjaku e traditë fisërore, të lënë shijen e vargut që ngrihet majë buzësh, si pëshpërimë përvëluese e stinës së përgjakur,

kur re të zeza kishin rënë mbi Kosovë, një kohë tash më e arkivuar diku, ndonëse ato mbeten kujtime të rrudhosura mbi



trishtimin e viteve të shkuara, si gravura të pashlyeshme rrëfimesh të trishta. Ky vëllim poetik ka vulën e një ditari luftëpaqeje, ku të vargëzuara janë rrëfimet e historisë së një trualli.

Në qendër të subjektit në "Porta të hapura" është ëndërra për lirinë shpirtërore

dhe kombëtare, që u bë pre e skllavërimit të gjatë serb. Jeta e izoluar, në marginalizim të artit dhe kulturës, që prangim shpirtëror, që pati çmim të lartë për brezin e viteve të '90, andaj po ata shpirtëra çohen peshë si dallgë të tërbuara, sapo ua hedh një sy LIRIA - ky emërtim ëndërrash si ndonjë pranverë e shumëpritur. Në këtë stinë la gjurmë edhe një luftëtare, një shpirt gruaje, një poete..., të cilës më shumë se ëndërrat i vlenë liria. Një lidhje e ngjeshur midis jetës dhe vdekjes, përjetimit të lumtur dhe hidhërimit të shpirtit, qëndron edhe te vetë poetja, tepër e brishtë në prekjën e ëndërrës së saj, por tejet e ashpër në theqafje të botës së padrejtë, për të kaluar kushdo qoftë jetën në ankthin e frikës dhe mëkatit. Jeta për të nënkupton lumturi, drejtësi, dashuri... Simboli i lirisë, flijimi për diellin e së nesërme, në Kosovë kanë të njëjtën vatër lindjeje - Drenicën, edhe pse aso kohe, shumë herë plumbat vrisnin edhe ëndërra.

Viti '99 është simbolika që e deshifron tërë tmerrin e epokës... "Jam rrënja, uji e djersa...", shkruan poetja: "Aroma e tokës/ Unë themeli juaj dhe ëndërra/Gjuha dhe fytyra pa grim/Mos më flijoni si Rozafë/ Jam rrënja, uji e djersa/ Kurrizi, kënga e gëzimi/Gjiri juaj dhe loti/ Më

mbani në prehër" (Kultura në komë, 25). Si mund të rrimë indiferent ndaj vargjeve "Aroma e tokës...", kur në to ndiejmë zërin e thekshëm të krijueses që me kurajon intelektuale dhe dinjitetin e palëkundshëm njerëzor reflekton mesazhet e shpirtit?

Zëri i saj është i brishtë, femëror, por jo gjithëherë, sepse poetja shpreh brengën për popullin shqiptar. Në Kosovën e para viteve '90, qenë të shumta vajzat e kësaj toke që ëndërrat e tyre rinore, për aromë trëndafilash e kopshte trëndelinash, i zëvendësuan me aromë baroti e beteja arenash të përgjakura. Ky qe fati i mijëra vajzave kosovare që ishin brumosur me dashurinë për këtë dhe. "Më quajti trëndafil të egër/ Dhe të tillë më dëshiroje/ U gjakose gjembave të mi/ Nga nëntëdhjetë e nëntë përpjekje/ Të më doje..." (Magjistari, 24).

Frymëzimi poetik është nxitur nga ngjarjet konkrete ku si në teatër hapen pamje që e zotërojnë autoren. Poetja, është brenda këtij teatri apo është imagjinata e saj që ngjitet bëmave të këtij realiteti. Sigurisht, vargjet jetësohen mbi metaforat e poetes, të cilat e qartësojnë mesazhin e kësaj dileme?!

Urime poetja Shefqete në krijimtarinë tuaj!

Përgatitë nga  
Zejnepe Alili-Rexhepi

# KUSH JEMI NE SHQIPTARËT

- Figura të mëdha historike me origjine shqiptare -

Sot, kur Shqipëria po kalon procesin e «Globalizmit», atë poçes të cilin po e kalojnë të gjitha vendet dhe të cilin Papa Françesku e ka quajtur «Proces i konsumimit», ne duhet ti rikthehemi historisë dhe të njohim kush ishim dhe kush jemi gjatë rrjedhës së historisë nder shekuj.

Aleksandëri e Madh

Aleksandri i Madh (Leka i Madh) ka qene gjithmonë i quajtur si maqedonas-grek, nen pretekstin se ai kishte sundue mbi Helenet pas vdekjes së babës së tij-Filipit II, pushtues i Greqisë së Vjetër. Më përpara maqedonasit njiheshin si një popull barbar (i huaj). Kjo gjuhe barbare (e huaj) ishte gjuha Pellazgo-Ilirio-Thrake-Shqipe. Për greket, pasi u nënshtrua nga Filipi II, mbreti i Maqedonisë, i dhanë të drejte vetes që ta griqizonin, duke haruar se e kishin quajtur gjithmonë barbar (të huaj) dhe se ai fliste në gjuhen barbare (të huaj), që nuk ishte aspak greke. Për më tepër Aleksandërit i u desh me mesue greqishten nga filozofi i madh-Aristoteli, i cili edhe ai ishte një maqedonas-Ilir. Mësuesi e nxënësi flisnin atë gjuhe (barbare) mes tyre, gjuhen e vendlindjes-La langue Pelasko-Thrako-Shqipe. Mbi Aleksandëri e Madh jane shkruar shumë libra dhe dihet po thuaj gjithçka mbi te, përveç faktit që ai ishte me origjine shqiptare, sepse kishte dale nga një popull vëlla me shqiptaret, i cili deri në pushtimin sllav (shekulli VIII-XII pas Krishtit) flisnin të njëjtën gjuhe dhe që e flasin ende edhe sot në Maqedoninë Shqiptare. Në atë kohë të lashte, maqedonas do të thoshte shqiptare. Sllavet e Maqedonisë nuk kane të bëjnë fare me popujt e vjetër Pellazgo-Ilire-Thrake. Sllavet ishin barbare në kuptimin e plote të popujve të egër e injorante, që shkaktuan dëme të mëdha në gjith Evropën dhe që e kthyen mbrrapa 1 000 vjet qytetërimin evropian.

Jemi të detyruem të bajme ketë ndërhyrje, sepse pikërisht mbi ketë ekui-



vok historike që asht ndertue historia e antikitetit duke mohue të vërtetën në leverdi të një historie të manipulueme në kurriz të popullit shqiptar, i denuem pa drejtësisht nga ngjarjet që u përplasen mbi të gjate shumë shekujsh, pa i lanë asnjë mundësi që të rifitonte të kaluemen e tij të lavdishme.

Aleksandri u lind në Pella, në vitin 356 para Krishtit. Pas vdekjes së babës, mbretit Filipi II, ai nënshtrou Greqinë e rrebelueme dhe mori në Karinth titullin e Shefit të Grekeve kundër persianeve. Kaloj Hellenizmin dhe i mundi ushtritë e Darius III në Kranik dhe në Issos, mori Tiran dhe Egjiptin. Themeloi Aleksan-

drinë, pastaj duke kalue Eufurin e Tigrin (lumenj) i mundi persianet dhe pushtoi Babiloninë e Suzen, dogji Parsen dhe ariti në Indi. I kthym në Babiloni, u orvat të pushtoi dhe të organizoje pushtime të tjera duke formuar një popull të vetëm me fitimtare e të mundur. Por, Perandoria që ai kishte krijuar nuk mbi jetoi dhe pas vdekjes së tij, me 323, u nda midis gjeneralëve të tij.

Shkrimtari e historiani i njohur grek-Plutarku, na ka lanë një biografi të bukur të Aleksandërit të Madh, në veprën e tij kryesore «Jete Paralele», që e krahason me Jul Cezarin.

(Ref: «Cambridge university Presse Historia e Botes Antike», vep. 279)

Pirro i Epirit

Një shtet i randesishem ishte krijuar në Epir nën mbretin Pirro, që ishte në krye të Lidhjes Epirote në vitin 297 dhe që mbretëroi mbi Epirin gjatë një çerek shekulli. Kufijtë e mbretërisë së Epirit shtriheshin në Lindje deri te lumi Vardar, në Jug deri në gjirin e Peloponezitetit e në Veri deri në lumin Shkumbin.

Pirro ishte kushëri i Aleksandërit të Madh nga ana e nanës së Aleksandërit, Olimpia, gruaja e Filipit II. Këto lidhje provojnë ende edhe njëherë afrimin dhe të përbashkëtat e këtyne popujve jo greke. Ata ishin Thrako-Iliriane, që kishin krijuar popuj e mbretëri të pavaruna, të dalun nga një djep pellazgjik. Në Greqi, këto dy figura të mëdha Iliriane shkuen si pushtues e jo si greke. E udhëhequn nga mbreti i saj dhe e mire stërvitun, ushtria epirote u forcue në beteja fitimtare dhe u ndesh me ushtritë ma të njohuna të kohës. Pirro fitoi një përvojë të madhe si shef ushtarak. Usharet e thërrisnin «Shqipe» dhe ai u përgjigjej: «Në qofte se unë jam Shqipe, ju jeni flatrat e mija», prej kah ma vone simboli i Flamurit Shqiptar, i kuq me shqipen dy krenare të zeze, shqiptaret quhen «bijtë e shqipes».

Hipoteza se, shqiptaret u quajtën te tille nga pushtuesi osman për shkathtësinë në grabitje, bie poshtë. Me kërkesën e qyteteve Ilire në Jug të Italisë e të Sicelise, Pirro nisi luftën kundër romakeve dhe kartagjenasve. Mbreti u nis me një armate të madhe dhe njëzetë elefantë që u futen tmerrin ushtrive romake. Ata nuk kishin pa kurrë të tille pakiderme. Fillimisht Ai i mundi romaket në Herakli, fale elefantëve. Ma vone, në Askulum korri një fitore që i kushtoi shtrenjtë, me humbje të mëdha, prej kah mbeti thanja e famshme e tij: «Edhe një fitore si kjo dhe jam i humbun! Fitore si ajo e Pirros!». U mund përfundimisht në Maleventun, në vitin 275 para Krishtit. U kthye i rraskapitun pas gjashtë vjet fushatash ushtarake që i kushtuan shumë shtrenjtë. Nuk vonoj dhe rinisi luftën kundër Maqedonisë dhe Spartës, duke mbetur i vramë në luftimet neper rrugët e Argos.

Pirro çmohet nga shqiptaret si një Ilirian i lavdishëm dhe një hero shqiptar i antikitetit. Shumë shqiptar e mbajnë me krenari emnin e tij. Ai u shqu për aftësitë e theksueme si udhëheqës, strateg dhe organizator i zoti. Me një trup atleti ishte një luftëtar i madh, gjithmonë në radhe të pare dhe vendimtare në shumë beteja.

Gjykimet mbi të janë të ndryshme. Disa e konsiderojnë si një nder komandantet ma të mëdhenj të antikitetit, që arrijnë ta krahasojnë me Aleksandëri e Madh, kushërinin e tij. Me 25 vjet luftëra-Pirro ndërtoi lavdinë e tij dhe e ngriti personalitetin e tij në nivelin e njerëzve të mëdhenj të historisë së Shqipërisë dhe të mbare njerëzimit.

Pra, evidentojmë me kënaqësi dhe krenari, Lavdia e shqiptareve e ka themelin që në Antikitet. Me krenarinë e paraardhësve tanë nuk duhet vetëm të mburremi, por duhet të jemi dhe vijues të saj.

Mark Bregu

**Fotolajm:**  
Moti i keq, me rreshje bore bllokoi komnat malore të Dukagjinit, si dhe dëmton antenat e AMC-së dhe Vodafonit në Koman.

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra  
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

